LIGJ
Nr. 74/2021

PËR HEDHJEN NË TREG DHE MBIKËQYRJEN E LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton:

1. Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të lëndëve plasëse për përdorim civil, në mënyrë që të garantohet dhe të sigurohet përputhshmëria e tyre me kërkesat ligjore në drejtim të sigurisë, shëndetit, mbrojtjes së interesave të publikut dhe konkurrencës së drejtë në tregun vendas.

2. Kushtet dhe kriteret për prodhimin, importimin, eksportimin, tregtimin, transportimin, transferimin, magazinimin, përdorimin, transitin, asgjësimin, kërkimin, testimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve plasëse, si dhe kriteret për mbikëqyrjen dhe aplikimin e këtij ligji me qëllim mbrojtjen e njerëzve, pasurisë dhe mjedisit.

3. Mënyrën e organizimit, të drejtat dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për kontrollin, mbikëqyrjen dhe sigurinë gjatë zinxhirit të furnizimit deri te përdoruesi final.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për lëndët plasëse për përdorim civil.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

a) lëndët plasëse, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin vendas në fushën e mbrojtjes, sigurisë kombëtare dhe rendit publik nga Forcat e Armatosura ose Policia e Shtetit;

b) artikujt piroteknikë;

c) municionet, të cilat përdoren sipas legjislacionit vendas.

3. Shtojca I përmban një listë të artikujve piroteknikë dhe municioneve të referuara në shkronjën "b" të pikës 2 të këtij neni dhe në pikën 17 të nenit 3, që identifikohen respektivisht sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara për transportimin e mallrave të rrezikshme.

---

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me Direktivën 2014/28/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014 "Mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil". Numri CELEX 32014L0028 Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 96, datë 29.3.2014, faqe 1–44.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Akreditim" është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara, siç jepet në legjislacionin në fuqi për standardizimin dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

2. "Asgjësimi i lëndëve plasëse" është shkatërrimi përfundimtar i lëndëve plasëse përmes detonimit dhe/ose incinerimit ose përmes konvertimit të tyre në lëndë joplasëse, me anë të procedurave të tjera, duke respektuar kriteret e sigurisë dhe kriteret e përcaktuara për vlerësimin e ndikimit në mjedis të substancave shpërthyese.

3. "Autorizim" është vendimi i marrë nga autoriteti shtetëror, që i njeh titullarit të saj të drejtën të kryejë një ose disa veprime për lejimin e transferimit, eksportimit, importimit, transitimit, magazinimit, përdorimit ose asgjësimit të lëndëve plasëse. Kusht për marrjen e autorizimit është pajisja e operatorit ekonomik me licencën përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

4. "Certifikatë e përdoruesit fundor" është një dokument i lëshuar me kërkesë të përdoruesit fundor, i certifikuar nga një organ kompetent i vendit të përdoruesit fundor të lëndës plasëse.

5. "Eksport" ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në Kodin Doganor.

6. "Eksportues" është çdo person fizik/tregtar ose juridik, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili eksporton lëndë plasëse që prodhohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

7. "Bërje e disponueshme e produktit në treg/hedhje në treg" është çdo furnizim i lëndës plasëse në treg për shpërndarje, konsum ose përdorim të tij gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.

8. "Import" ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në Kodin Doganor.

9. "Importues" është çdo person fizik/tregtar ose personi juridik me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili vendos në treg një lëndë plasëse që vjen nga një vend i huaj.

10. "Inspektim" është çdo formë kontrolli që organi publik kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

11. "Kthim i produktit" është çdo masë për kthimin mbrapsht të një lënde plasëse, që është bërë ndërkohë e disponueshme te përdoruesi i fundit.

12. "Lëndë jofunksionale" është lënda plasëse, e cila nëpërmjet një procesi teknologjik kthehet në lëndë joplasëse dhe humbet totalisht fuqinë shpërthyese.

13. "Lëndë plasëse" janë të gjitha ato bashkime ose përzierje të ndryshme kimike, të cilat pa praninë e oksigjenit, nën ndikimin e ngacmimeve të jashtme, pësojnë ndryshime shumë të shpejta fiziko-kimike, të shoqëruara me temperaturë të lartë dhe çlirim gazrash në sasi e presion të lartë, të afta për të kryer punë, që plotësojnë standardet e përdorimit në veprimtari civile, si dhe materialet dhe artikujt që konsiderohen lëndë plasëse sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave të rrezikshme dhe që kategorizohen në klasën 1 të këtyre rekomandimeve.

14. "Licencë" është vendimi i marrë nga autoriteti shtetëror që i njeh titullarit të saj të drejtën të ushtrojë veprimtari si operator ekonomik për të prodhuar, importuar, eksportuar dhe tregtuar lëndë plasëse ose të pajiset me autorizim për transferimin, transitin, eksportin dhe importin e lëndëve plasëse.

15. "Magazinë e përkohshme" është një dhomë, kriteret e ndërtimit, ato teknike dhe të sigurisë të së cilës përcaktohen me rregullore të veçantë nga struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon çështjet minerare dhe që synohet të përdoret për magazinimin e lëndëve plasëse.

16. “Magazinim” është mbajtja e lëndëve plasëse gjatë prodhimit, tregtimit dhe përdorimit në mjediset e synuara për atë qëllim.

17. “Markim CE” është markimi me të cilin prodhuesi tregon që produkti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon vendosjen e këtij markimi.

18. “Mbikëqyrje e tregut” janë veprimtaritë e kryera dhe masat e marra nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut (më poshtë “struktura përgjegjëse”) për të garantuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat ligjore në lidhje me të, me qëllim që të mos rrezikohen shëndeti, siguria ose aspekte të tjera të mbrojtjes së interesit publik.

19. “Municione” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për armët.

20. “Ndalim i tregtimit” është çdo masë e marrë përgjatë të gjithë zinxhirit të furnizimit për të parandaluar hedhjen në treg të lëndës plasëse.

21. “Numri i Kombeve të Bashkuara” është numri identifikues dhe shkalla e rrezikshmërisë së materialeve të rrezikshme, ndezëse dhe shpërthyese, të renditura në tabelën e Marrëveshjes Evropiane për Transportimin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme.

22. “Objekte për magazinimin dhe prodhimin e lëndëve plasëse” janë objekte të mbyllura dhe të kontrolluara, të synuara për prodhimin, magazinimin, ngarkimin dhe shkarkimin e lëndëve plasëse, të cilat janë të ndërtuara dhe të pajisura në mënyrë të tillë që garantojnë mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, mbrojtjen e pronës dhe të mjedisit.

23. “Operator ekonomik” është prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi, shpërndarësi dhe çdo person tjetër fizik/tregtar ose juridik, i cili ka si objekt të veprimtarisë së tij magazinimin, përdorimin, transferimin, importimin, eksportimin, tregtimin ose asgjësimin e lëndëve plasëse.

24. “Organ i miratuar” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin përkatës për mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

25. “Organi i vlerësimit të përputhshmërisë” është organi që kryen procesin e vlerësimit të përputhshmërisë, duke përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

26. “Organizëm evropian i notifikuar” është organizmi i vlerësimit të përputhshmërisë, i miratuar nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, i notifikuar prej këtij të fundit në Komisionin Evropian (KE) dhe i regjistruar në faqen zyrtare të KE-së si një trup kompetent për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të përputhshmërisë së produktit për vendosjen e markimit CE.

27. “Organizëm kombëtar i akreditimit” është organi sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për akreditimin.

28. “Përdorimi i lëndëve plasëse” është përgatitja e drejtpërdrejtë për aktivizim dhe aktivizimi i lëndëve plasëse.

29. “Përfaqësuesi i autorizuar” është çdo person fizik/tregtar ose juridik me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili ka marrë nga prodhuesi një autorizim me shkrim për të vepruar në emër të tij në lidhje me detyra të caktuara.

30. “Prodhim i lëndëve plasëse” është prodhimi, përpunimi ose modifikimi i lëndëve plasëse, si dhe montimi e çmontimi i tyre.

31. “Prodhuesi” është një person fizik/tregtar ose juridik, i cili prodhon një lëndë plasëse ose bën të mundur projektimin ose prodhimin e saj dhe e tregton atë me emrin e tij apo markën tregtare ose e përdor për qëllime të veta.

32. “Rregullat teknike të lëndëve plasëse” janë rregullat që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse.

33. “Siguri”, në kuptim të këtij ligji, është parandalimi i aksidenteve dhe atëherë kur parandalimi dështon, minimizimi i pasojave të tyre.

34. “Siguri publike” është parandalimi i përdorimit të lëndëve plasëse për qëllime që bien në kundërshtim me rendin publik.

35. “Specifikime teknike” është një dokument, i cili përshkruan kriteret teknike që duhet të përmbushë një lëndë plasëse.

36. "Standard shqiptar i harmonizuar" është standardi shqiptar, që transpozon një standard të harmonizuar evropian, siç jepet në legjislacionin në fuqi për standardizimin, në mbështetje të këtij ligji dhe të rregullave teknike, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, në bashkërendim me ministritë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në Fletoren Zyrtare.

37. "Subjekti i inspektimit" është çdo person fizik/tregtar ose juridik, privat ose publik, që ka sipas ligjit detyrimin të respektojë një kërkesë ligjore.

38. "Shpërndarës" është çdo person fizik/tregtar ose juridik në zinxhirin e furnizimit, i ndryshëm nga prodhuesi ose importuesi, i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij hedh në treg një lëndë plasëse.

39. "Tërheqje nga tregu" është çdo masë e marrë nga operatorët ekonomikë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, që synon parandalimin e daljes në treg të lëndës plasëse në zinxhirin e furnizimit.

40. "Trajtim i lëndëve plasëse" është kryerja e veprimeve në lidhje me prodhimin, testimin, magazinimin, tregtimin, transportimin, përdorimin e lëndëve plasëse.

41. "Transferim" është çdo lëvizje fizike e lëndëve plasëse brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe transportin tokësor dhe detar të lëndëve plasëse, që hyjnë dhe kalojnë përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, me destinacion një vend jashtë Shqipërisë dhe pa ndërruar pronësinë e mallrave, përveç lëvizjeve brenda kantierit ose vendit të punës.

42. "Transit" është regjimi doganor sipas përcaktimeve të Kodit Doganor.

43. "Tregtar" është çdo person fizik ose juridik, që ka si objekt veprimtarie tregtimin apo shkëmbimin e lëndëve plasëse.

44. "Vendosja në treg" është bërja e disponueshme për herë të parë e lëndës plasëse në tregun vendas.

45. "Vërtetim besueshmërie" është akti administrativ i organit përgjegjës të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, ku dokumentohet procesi i verifikimit të të dhënave të individit në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të të gjitha institucioneve shtetërore.

46. "Vlerësimi i përputhshmërisë" është procesi nëpërmjet të cilit përcaktohet plotësimi ose jo i kritereve thelbësore të sigurisë, që kanë të bëjnë me lëndën plasëse.

KREU II
DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË

Neni 4
Detyrimet e prodhuesve

1. Prodhuesit, kur hedhin në treg lëndët plasëse ose kur i përdorin për qëllime të tyre, sigurohen që ato të jenë projektuara dhe të prodhuara në përputhje me kriteret thelbësore të sigurisë, të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji.

2. Prodhuesit hartojnë dokumentacionin teknik sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën III dhe sipas procedurës së përshtatshme të vlerësimit të përputhshmërisë, të përcaktuar në nenin 16 të këtij ligji. Procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë kryhen nga vetë prodhuesit sipas kërkesave të këtij ligji.

3. Në rastin kur procedura përcakton se lënda plasëse është në përputhje me kriteret e përputhshmërisë, prodhuesi harton një deklaratë të përputhshmërisë së BE-së dhe vendos markimin CE.

4. Prodhuesit ruajnë dokumentacionin teknik dhe deklaratën e përputhshmërisë së BE-së për një periudhë 10-vjeçare pasi lënda plasëse është hedhur në treg.

5. Prodhuesit sigurohen që zbatimi i procedurave për prodhimin në seri të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

6. Modifikimet në projektim ose ato të lidhura me karakteristikat e lëndës plasëse, si dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara ose ndryshimet e specifikimeve të tjera teknike për bazën e të cilave është deklaruar përputhshmëria e lëndës plasëse, duhen marrë parasysh dhe duhet të reflektohen në dokumentacionin shoqërues të produktit.

7. Prodhuesit sigurohen që lëndët plasëse, të cilat janë hedhur në treg, kanë një kod identifikimi unik në përputhje me sistemin e identifikimit dhe gjurmueshmërinë e lëndëve plasëse, të përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji.

8. Për lëndët plasëse të përjashtuara nga sistemi i gjurmimit, prodhuesit duhet:

a) të sigurohen që lëndët plasëse, të cilat kanë hedhur në treg, kanë një model/lloj, numrin e lotit ose të serisë apo elemente të tjera që mundësojnë identifikimin e tyre ose në rastet kur masa e vogël, forma ose projektimi i lëndëve plasëse nuk e mundëson një gjë të tillë, atëherë informacioni i kërkuar vendoset te paketimi ose në një dokument që shoqëron lëndën plasëse;

b) të paraqesin te lënda plasëse emrin e tyre, emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare dhe adresën postare ku mund të kontaktohen ose në rast se një gjë e tillë është e pamundur, ky informacion duhet të vendoset te paketimi i tij ose te një dokument shoqërues i lëndës plasëse. Adresa tregon një pikë të vetme ku mund të kontaktohet prodhuesi. Të dhënat e kontaktit të jenë në gjuhën shqipe lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit e fundit dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.

9. Prodhuesit sigurohen që lënda plasëse që kanë hedhur në treg, të shoqërohet me udhëzimet dhe informacionin e sigurisë në gjuhën shqipe që mund të kuptohet lehtë nga përdoruesi i fundit. Udhëzimet dhe informacionet e tilla të sigurisë, si edhe etiketimi të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të thjeshta.

10. Prodhuesit, që vlerësojnë ose kanë arsye të besojnë se lënda plasëse që kanë hedhur në treg nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, marrin menjëherë masat e nevojshme për korrigjimin e mospërputhshmërisë së lëndës plasëse, për ndalimin e tregtimit ose për kthimin e produktit, nëse është e përshtatshme.

11. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, prodhuesit informojnë menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë hollësi, sidomos për mospërmbushjen e kritereve dhe për masat korrigjuese të ndërmarra.

12. Prodhuesit, në bazë të kërkesës së arsyetuar nga ana e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, japin në gjuhën shqipe të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, në formë shkresore ose elektronike, që nevojitet për të provuar përputhshmërinë e lëndës plasëse me dispozitat e këtij ligji.

13. Prodhuesit duhet të bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut, në vijim të kërkesës së tyre, për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut që paraqitet nga lëndët plasëse, të cilat i kanë hedhur në treg.

14. Prodhuesit në fazën e projektidesë për prodhimin e lëndëve plasëse duhet t'i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), si dhe të sigurojnë lejet përkatëse mjedisore për prodhimin e lëndëve plasëse përpara vënies në punë të instalimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe atij për lejet e mjedisit. Modifikimet në projektim ose në instalimet e prodhimit, që janë të lidhura me karakteristikat/standardet e harmonizuara të lëndës plasëse apo ndryshimet në specifikimet teknike duhet të jenë pjesë e VNM-në dhe lejes përkatëse të mjedisit.

Neni 5

Përfaqësuesit e autorizuar

1. Prodhuesi mund të caktojë një përfaqësues me anë të një autorizimi me shkrim.

Detyrimet e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 4 të këtij ligji nuk mund t'i delegohen përfaqësuesit të autorizuar.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e caktuara në autorizimin e lëshuar nga prodhuesi.

3. Autorizimi i jep të drejtën përfaqësuesit të autorizuar që minimalisht:

a) të ruajë deklaratën EU të përputhshmërisë dhe dokumentacionin teknik për ta vënë në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrëse të tregut të vendit në rast kërkese, për 10 vjet pasi lëndët plasëse të kenë dalë në treg;

b) në përgjigje të një kërkese të arsyetuar të strukturave të mbikëqyrjes së tregut, të vendosë në dispozicion të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar përputhshmërinë e një lënde plasëse me dispozitat e këtij ligji;

c) me kërkesë të strukturave të mbikëqyrjes së tregut, të bashkëpunojë për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut të paraqitur nga lëndët plasëse, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në autorizimin e përfaqësimit.

Neni 6

Detyrimet e importuesve

1. Importuesit vendosin në treg vetëm lëndët plasëse që përmbushin kriteret e përputhshmërisë.

2. Përpara hedhjes në treg të lëndës plasëse, importuesit sigurohen që:

a) prodhuesi të ketë kryer procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij ligji;

b) prodhuesi të ketë hartuar dokumentacionin teknik;

c) lënda plasëse të ketë të vendosur markimin CE;

ç) lënda plasëse të shoqërohet me dokumentet e nevojshme për hedhjen në treg;

d) prodhuesi të ketë plotësuar kriteret e përcaktuara në pikat 7 dhe 8 të nenit 4 të këtij ligji.

3. Kur importuesi vlerëson se një lëndë plasëse nuk është në përputhje me kriteret thelbësore të sigurisë, të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji, nuk e vendos në treg lëndën plasëse deri sa lënda plasëse të jetë në përputhje me kriteret e përputhshmërisë.

4. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, importuesi informon prodhuesin dhe strukturat e mbikëqyrjes së tregut në lidhje me këtë fakt.

5. Importuesit te lënda plasëse në gjuhën shqipe duhet të vendosin:

a) emrin e tyre;

b) emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare;

c) adresën ku mund të kontaktohen ose, nëse kjo është e pamundur, e vendosin atë mbi paketimin apo në një dokument shoqërues të lëndës plasëse.

6. Importuesit sigurohen që lënda plasëse shoqërohet nga udhëzimet dhe informacioni për sigurinë në gjuhën shqipe.

7. Importuesit sigurohen që, ndërkohë që lënda plasëse është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit ose transportimit përmbushin kriteret thelbësore të sigurisë të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji.

8. Importuesit, që vlerësojnë se lënda plasëse e hedhur në treg nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, menjëherë marrin masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë lëndën plasëse në përputhje me kërkesat, për ta tërhequr ose për ta rikthyer, nëse një gjë e tillë është e përshtatshme. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, importuesit informojnë për këtë çështje menjëherë strukturat e mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë hollësi, sidomos për çështjen e mospërputhjes dhe çdo masë korrigjuese të ndërmarrë.

9. Importuesit ruajnë për 10 vjet pas hedhjes në treg të lëndës plasëse një kopje të deklaratës së përputhshmërisë EU në dispozicion të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe sigurojnë që dokumentacioni teknik mund t'u vihet në dispozicion këtyre autoriteteve sipas kërkesës.

10. Importuesit:

a) në bazë të kërkesës së arsyetuar nga ana e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut japin të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në formë shkresore ose elektronike që nevojitet për të provuar përputhshmërinë e lëndës plasëse me dispozitat e këtij ligji, në gjuhën shqipe;

b) bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut, në vijim të kërkesës së tyre, për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut që paraqitet nga lëndët plasëse, të cilat i kanë hedhur në treg.

Neni 7

Detyrimet e shpërndarësve

1. Shpërndarësit kur hedhin në treg një lëndë plasëse duhet të përmbushin dispozitat e këtij ligji.

2. Përpara hedhjes në treg të lëndës plasëse, shpërndarësit duhet të verifikojnë nëse:

a) lënda plasëse ka markimin CE;

b) lënda plasëse shoqërohet nga dokumentet e nevojshme, si: udhëzimet dhe informacionet e sigurisë në gjuhën shqipe;

c) prodhuesi dhe importuesi kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në pikat 7 e 8 të nenit 4 dhe në pikën 5 të nenit 6 të këtij ligji.

3. Kur shpërndarësi vlerëson se lënda plasëse nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji, ai nuk e vendos në treg lëndën plasëse derisa ajo lëndë të jetë në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin, si dhe strukturat e mbikëqyrjes së tregut.

4. Shpërndarësit sigurojnë që për aq kohë sa lënda plasëse është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit apo transportit nuk cenojnë përputhshmërinë dhe përmbushjen e kritereve të sigurisë, të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji.

5. Kur shpërndarësit vlerësojnë se lënda plasëse e hedhur në treg nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ata sigurohen për marrjen e masave korrigjuese për eliminimin e mospërputhshmërisë për ta tërhequr ose për ta rikthyer atë, sipas rastit. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, shpërndarësit informojnë menjëherë strukturat e mbikëqyrjes së tregut duke dhënë hollësi për çështjen dhe për çdo masë korrektuese të ndërmarrë.

6. Shpërndarësit:

a) bazuar në kërkesën e arsyetuar të strukturave të mbikëqyrjes së tregut, paraqesin të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në formë shkresore apo elektronike për të provuar përputhshmërinë e lëndës plasëse;

b) bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut, në vijim të kërkesës së tyre, për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut që paraqitet nga lëndët plasëse, të cilat i kanë hedhur në treg.

Neni 8

Zbatimi i detyrimeve të prodhuesve nga importuesit dhe shpërndarësit

Një importues ose shpërndarës konsiderohet prodhues për qëllim të këtij ligji dhe u nënshtrohet detyrimeve që ka prodhuesi nëse vendos në treg një lëndë plasëse me emrin e tij, markën e tij tregtare ose nëse modifikon lëndën plasëse të dalë në treg në atë mënyrë që mund të ndikojë te përputhshmëria me dispozitat e këtij ligji.

Neni 9

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Në lidhje me lëndët plasëse që nuk janë pjesë e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit, operatorët ekonomikë, në vijim të kërkesës, identifikojnë tek autoritetet e mbikëqyrjes së tregut si më poshtë:

a) çdo operator ekonomik që i ka furnizuar ata me lëndë plasëse;

b) çdo operator ekonomik që ata kanë furnizuar me lëndë plasëse.

2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni për një periudhë kohore 10-vjeçare pas furnizimit me lëndën plasëse dhe për një periudhë 10-vjeçare pasi ata të kenë furnizuar dikë me lëndë plasëse.

KREU III
DISPOZITAT E SIGURISË

Neni 10
Transferimi i lëndëve plasëse

1. Lëndët plasëse transferohen vetëm në përputhje me përcaktimet sipas pikave të mëposhtme.

2. Miratimi për transferimin e lëndëve plasëse sigurohet prej aplikuesit nga struktura përkatëse në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, e cila verifikon që marrësi të jetë ligjërisht i autorizuar për të marrë lëndë plasëse dhe që zotëron licencat ose autorizimet e nevojshme.

3. Operatori ekonomik përgjegjës për transferimin njofton strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë për transferimin e lëndës plasëse ose strukturën përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes për kalimin transit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë dhe pajiset me autorizimin përkatës.

4. Për transferimin e brendshëm të lëndëve plasëse mund të nxirret autorizim për transferim të herëpashershëm të lëndëve plasëse brenda periudhës së vlefshmërisë deri në 1 vit, të përcaktuar në marrëveshjen midis operatorëve ekonomikë, me kusht që çdo transferim t'u njoftohet strukturave vendore në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, sipas pikës së nisjes së transportit, brenda jo më pak se 24 orëve përpara fillimit të transportit.

5. Në rast se ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë miraton një transferim, ajo i lëshon marrësit një dokument që përfshin të gjithë informacionin e përmendur në pikën 8 të këtij neni.

6. Në rast se struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes miraton kalimin transit të lëndës plasëse, ajo i lëshon marrësit një dokument që përfshin të gjithë informacionin e përmendur në pikën 8 të këtij neni.

7. Ky dokument shoqëron lëndët plasëse deri në mbërritjen e tyre në destinacionin e përcaktuar. Dokumenti paraqitet sa herë që kërkohet nga autoritetet kompetente.

8. Në rast se transferimet e lëndëve plasëse duhet t'i nënshtrohen një mbikëqyrjeje të veçantë për të përmbushur kërkesat e posaçme të sigurisë në territorin ose në një pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë marrësi i jep strukturës përgjegjëse përpara transferimit informacionin e mëposhtëm:

a) emrat dhe adresat e operatorëve ekonomikë dërgues dhe marrës;

b) numrin dhe sasinë e lëndës plasëse që transferohet;

c) një përshkrim të plotë të lëndëve plasëse që transferohen dhe të mënyrave të identifikimit, duke përfshirë edhe numrin e identifikimit të Kombeve të Bashkuara;

ç) vendin ku do të vendosen në treg lëndët plasëse, informacionin për përmbushjen e kushteve për vendosjen në treg;

d) mjetet që do të kryejnë transportin dhe itinerarin;

dh) datat e parashikuara të nisjes dhe mbërritjes;

e) në rast se është e nevojshme, pikat e sakta të hyrjes dhe të daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Informacioni i përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar në mënyrë që t'u mundësojë strukturave përgjegjëse të kontaktojnë operatorët ekonomikë dhe të sigurojnë konfirmimin se operatorët ekonomikë në fjalë kanë të drejtë të marrin dërgesën.

9. Operatori ekonomik i transferon lëndët plasëse vetëm nëse marrësi/dërguesi ka marrë autorizimet e nevojshme për transferim në përputhje me dispozitat e pikave 2, 3, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij neni.

Neni 11
Shkelje të sigurisë

1. Në rast të një kërcënimi serioz ose të një rreziku ndaj sigurisë publike, si rezultat i mbajtjes ose përdorimit jo të ligjshëm të lëndëve plasëse, ministria që mbulon rendin dhe sigurinë merr të gjitha masat e domosdoshme për të parandaluar transferimin, zotërimin ose përdorimin e paligjshëm të lëndëve plasëse.

2. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë mundet në çdo kohë t'u kërkojë autoriteteve licencuese ndalimin e prodhimit dhe çdo aktivitet tregtar, si dhe mund të kërkojë magazinimin e lëndëve plasëse në ambientet e posaçme të autoriteteve të sigurisë publike ose ushtarake, në rast të një kërcënimi serioz ose të një rreziku ndaj sigurisë publike.

3. Masat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Ato nuk duhet të jenë masa diskriminuese dhe as shtrënguese ndaj aktiviteteve tregtare.

Neni 12
Masat e sigurisë

1. Gjatë kryerjes së veprimtarive të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, operatorët ekonomikë kujdesen që të mbrojnë jetën e shëndetin e njerëzve dhe pronën e tyre, si dhe të marrin të gjitha masat e sigurisë, të përcaktuara në këtë ligj dhe në rregulloret e miratuara mbi bazën e këtij ligji.

2. Operatorët ekonomikë rregullojnë mënyrën e zbatimit të masave të përmendura në pikën 1 të këtij neni me rregullore të brendshme.

3. Rregullorja e brendshme, që përmendet në pikën 2 të këtij neni, duhet të përmbajë gjithashtu një plan veprimi në rast aksidenti ose emergjence tjetër (shpërthim, zjarr, vjedhje etj.).

4. Operatorët ekonomikë u njoftojnë masat e përcaktuara në rregulloren e brendshme sipas pikës 2 të këtij neni, të gjithë personave që kryejnë për llogari të tyre veprimtari të lidhura me lëndët plasëse dhe u ofrojnë atyre trajnimin e duhur për të vepruar në rast aksidenti.

5. Objektet për prodhimin ose magazinimin e lëndëve plasëse duhet të jenë në mbrojtje të përhershme fizike ose teknike, në përputhje me rregulloren e veçantë që rregullon fushën e mbrojtjes fizike dhe teknike.

6. Operatorët ekonomikë, që përdorin apo trajtojnë në çfarëdo mënyre lëndë plasëse, duhet të organizojnë dhe të mbikëqyrin zbatimin e masave mbrojtëse të parashikuara.

7. Operatorët ekonomikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, që përdorin lëndë plasëse, kujdesen për paketimin e tyre në përputhje me udhëzimet e prodhuesit ose të personit përgjegjës, të personit juridik ose sipërmarrësit apo të personit të autorizuar për të përfaqësuar prodhuesin.

8. Paketimi i lëndëve plasëse nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç paketimit të lëndëve plasëse për të cilat është miratuar.

9. Operatorët ekonomikë të angazhuar në prodhimin, magazinimin, tregtimin, shpërndarjen ose përdorimin e lëndëve plasëse njoftojnë menjëherë ministrin e Mbrojtjes, ministrin përgjegjës

për industrinë minerare dhe ministrin përgjegjës për rendin dhe sigurinë në rast humbjeje ose vjedhjeje të lëndëve plasëse.

10. Gjatë transportit të lëndëve plasëse përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, operatorët ekonomikë që kanë autorizimin, kanë detyrimin që në rast aksidenti të kujdesen sipas mënyrës së përcaktuar për lëndët plasëse dhe paketimin përkatës të tyre dhe në rast humbjeje ose vjedhjeje të lëndëve plasëse të njoftojnë ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë menjëherë sapo të marrin dijeni për humbjen apo vjedhjen e tyre.

11. Operatorët ekonomikë të angazhuar në prodhimin, tregtimin ose përdorimin e lëndëve plasëse, përpara se të ndërpresin kryerjen e veprimtarisë së tyre, duhet t'i asgjësojnë lëndët plasëse apo t'ia shesin ose t'ia transferojnë ato personit juridik ose fizik/tregtarit që ka licencë për prodhimin, tregtimin ose përdorimin e lëndëve plasëse, si dhe të përmbushin të gjitha detyrimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.

12. Ministri i Mbrojtjes, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë dhe ministri përgjegjës për industrinë minerare miratojnë një udhëzim që përcakton detyrimet dhe procedurat e operatorëve ekonomikë për zbatimin e masave të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 13

Trajnimet/kualifikimet

1. Personat, të cilët për nevojat e operatorit ekonomik angazhohen në prodhimin, importimin, eksportimin, tregtimin, transportimin, transferimin, magazinimin, përdorimin, asgjësimin, duke përdorur ose duke trajtuar drejtpërdrejt lëndët plasëse, duhet të jenë të aftë nga ana shëndetësore, të kualifikuar teknikisht dhe të trajnuar për kryerjen në mënyrë të sigurt të këtyre veprimtarive.

2. Aftësia shëndetësore, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, duhet të mbështetet edhe nga një vërtetim i gjendjes shëndetësore, lëshuar nga organi kompetent pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetin publik.

3. Trajnimi i kualifikimit teknik për punën me lëndët plasëse, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, do të ofrohet sipas programit dhe mënyrës së parashikuar nga ministria përgjegjëse për industrinë minerare.

4. Trajnimi i kualifikimit teknik i drejtuesve të mjeteve për transportimin e lëndëve plasëse, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, dhe pajisja me certifikatën përkatëse për transportin e mallrave të rrezikshme do të ofrohen sipas programit dhe mënyrës së parashikuar nga ministri përgjegjës për industrinë minerare dhe ministri përgjegjës për transportin, i cili do të zbatohet nga institucionet e autorizuara.

5. Pavarësisht përcaktimeve në pikën 1 të këtij neni, individët e angazhuar në veprimtari ndihmëse në lidhje me prodhimin, tregtimin, magazinimin, transportimin ose përdorimin e lëndëve plasëse (transferimi, ngarkimi, shkarkimi etj.) nuk kanë nevojë të kenë kualifikim teknik dhe vërtetim të aftësisë dhe ata mund të përfshihen në veprimtaritë e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, vetëm nën mbikëqyrjen e personit përgjegjës të kualifikuar teknikisht dhe me kusht që të deklarojnë me shkrim se janë informuar rreth rreziqeve dhe rregullave të sigurisë në vendin e punës.

6. Personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të jenë të pajisur me vërtetimin e besueshmërisë të lëshuar nga struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon rendin dhe sigurinë.

Neni 14

Identifikimi dhe gjurmimi i lëndëve plasëse

1. Operatorët ekonomikë i përmbahen një sistemi uniform për identifikimin unik dhe gjurmimin e lëndëve plasëse, që merr parasysh madhësinë, formën ose projektin e tyre, duke vendosur një identifikim unik mbi lëndën plasëse, bazuar në karakteristikat dhe faktorët e saj, siç

janë efektet e saj të ulëta detonuese, përdorimet e saj dhe rrezikun e ulët ndaj sigurisë që paraqet për shkak të efekteve të vogla potenciale të keqpërdorimit.

2. Ky sistem siguron grumbullimin dhe ruajtjen e të dhënave, duke përfshirë mjete elektronike, identifikimin unik dhe gjurmimin e lëndës plasëse, si edhe vendosjen e një identifikimi unik mbi lëndën plasëse dhe/ose në paketimin e saj që mundëson qasje në ato të dhëna. Këto të dhëna lidhen me identifikimin unik të lëndës plasëse, duke përfshirë vendndodhjen e saj, ndërkohë që është në zotërim të operatorëve ekonomikë dhe identitetin e atyre operatorëve ekonomikë.

3. Të dhënat e përmendura në pikën 2 të këtij neni testohen në intervale të rregullta dhe mbrohen nga dëmtimet ose shkatërrimet aksidentale ose dashakeqëse. Këto të dhëna ruhen për 10 vjet pas kryerjes së transaksionit ose, kur lëndët plasëse janë përdorur ose asgjësuar, 10 vjet pas përdorimit ose asgjësimit të tyre, edhe nëse operatori ekonomik ka ndërprerë tregtimin.

4. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve siguron që prodhuesit dhe importuesit e lëndëve plasëse për përdorim civil të pajisen me një sistem për mbledhjen e të dhënave, i cili përfshin identifikimin unik dhe poseduesin e tyre gjatë të gjitha fazave të procesit, nga prodhimi ose importimi deri në përdorimin e fundit, gjatë gjithë jetëgjatësisë së lëndëve plasëse për përdorim civil, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

5. Struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon çështjet e energjisë dhe mineraret merr të gjitha masat që operatorët ekonomikë, pjesë të zinxhirit të furnizimit për vendosjen në treg të lëndëve plasëse për përdorim civil, të pajisen me një sistem për mbledhjen e të dhënave, i cili përfshin identifikimin unik dhe poseduesin e tyre gjatë të gjitha fazave të procesit, nga prodhimi apo importimi deri në përdorimin e fundit, gjatë gjithë jetëgjatësisë së lëndëve plasëse për përdorim civil, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. Rregullat dhe procedurat e krijimit të sistemit të gjurmimit dhe identifikimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

KREU IV
VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË DHE ORGANET E VLERËSIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË

Neni 15
Prezumimi i përputhshmërisë së lëndëve plasëse

Lëndët plasëse që janë në përputhje me standardet shqiptare, standardet e harmonizuara ose me një pjesë të këtyre standardeve, referencat e të cilave janë të botuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë", prezumohen se janë në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë së këtyre standardeve ose të një pjese të tyre, të paraqitura në shtojcën II të këtij ligji.

Neni 16
Procedura e vlerësimit të përputhshmërisë

Për vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve plasëse, prodhuesi ndjek një nga procedurat e mëposhtme, të parashikuara në shtojcën III të këtij ligji:

a) kontrolli i tipit EU (Moduli B) dhe, sipas zgjedhjes së prodhuesit, një nga procedurat e mëposhtme:

i. përputhshmëria sipas tipit, e bazuar te kontrolli i brendshëm i produktit, si edhe kontrollet shtesë të mbikëqyrjes në intervale rastësore (Moduli C2);

ii. përputhshmëria sipas tipit, e bazuar te siguria e cilësisë së procesit të prodhimit (Moduli D);

iii. përputhshmëria sipas tipit, e bazuar te siguria e cilësisë së produktit (Moduli E);

iv. përputhshmëria sipas tipit, bazuar te verifikimi i njësisë (Moduli F);

b) përputhshmëria e bazuar në verifikimin e njësisë së produktit (Moduli G).

Neni 17
Deklarata e përputhshmërisë

1. Deklarata e përputhshmërisë dëshmon përmbushjen e kërkesave thelbësore të sigurisë, të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji.

2. Deklarata e përputhshmërisë së BE-së hartohet sipas modelit të parashikuar në shtojcën IV të këtij ligji, përmban elementet e përcaktuara te modulet përkatëse të parashikuara në shtojcën III dhe përditësohet vazhdimisht sipas rastit. Deklarata e përputhshmërisë së BE-së hartohet/përkthehet në gjuhën shqipe.

3. Duke hartuar deklaratën e përputhshmërisë, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 18
Rregullimet për markimin CE

Markimi CE është subjekt i parimeve të përgjithshme të përcaktuara në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Këto rregullime do të aplikohen për vendosjen e markimit CE mbi produktet e përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji.

Neni 19
Rregullat dhe kushtet për vendosjen e markimit CE

1. Markimi CE vendoset në mënyrë të dukshme te lëndët plasëse, i lexueshëm dhe i pamundur për t'u fshirë.

2. Kur kjo nuk është e mundur ose nuk është e garantuar për shkak të natyrës së lëndës plasëse, markimi vendoset në ambalazh dhe në dokumentet shoqëruese.

3. Markimi CE fiksohet përpara se lënda plasëse të hidhet në treg.

4. Markimi CE shoqërohet nga një numër identifikimi i strukturës së akreditуar, e cila është përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit.

5. Numri i identifikimit të strukturës së akreditуar vendoset nga vetë organi ose sipas udhëzimeve të tij nga ana e prodhuesit ose përfaqësuesi i autorizuar i këtij të fundit.

6. Markimi CE dhe numri i strukturës së akreditуar, kur është e mundur, shoqërohet edhe nga një shenjë tjetër që tregon rrezik apo përdorim të veçantë.

Neni 20
Organet e vlerësimit të përputhshmërisë

Vlerësimi i përputhshmërisë së lëndëve plasëse bëhet nga vetë prodhuesi nëpërmjet një organizmi evropian të notifikuar, kompetent për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të përputhshmërisë së produktit për vendosjen e markimit CE.

Kur një organizëm evropian i notifikuar tregon përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në standardet e harmonizuara, vërteton që lënda plasëse përmbush të gjitha standardet e sigurisë për t'u hedhur në treg.

KREU V
ADMINISTRIMI I LËNDËVE PLASËSE DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Neni 21

Strukturat përgjegjëse për administrimin

1. Lëndët plasëse për përdorim civil prodhohen, importohen dhe eksportohen në Republikën e Shqipërisë vetëm me licencë të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

2. Pas miratimit të licencës, operatorët ekonomikë mund të importojnë ose të eksportojnë lëndë plasëse duke u pajisur me autorizimin përkatës, të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

3. Lëndët plasëse për përdorim civil transferohen, magazinohen dhe asgjësohen vetëm me autorizim të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin publik.

4. Lëndët plasëse për përdorim civil përdoren vetëm me autorizim nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe çështjet minerare.

5. Lëndët plasëse për përdorim civil importohen dhe prodhohen në Republikën e Shqipërisë pasi të jenë verifikuar procedurat e përputhshmërisë së tyre nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

6. Lëndët plasëse për përdorim civil transitohen nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë me autorizimin përkatës të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

7. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për lëndët plasëse për përdorim civil do të jenë institucionet shtetërore të përcaktuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, sipas fushës së kompetencës dhe përcaktimeve të pikës 1 të nenit 24 të këtij ligji.

Neni 22

Kushtet e përgjithshme të administrimit

1. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, tregtimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, transitimin, përdorimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse me propozimin e ministrisë përgjegjëse, sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe, struktura përgjegjëse për dhënien e licencës/autorizimit urdhëron shfuqizimin e saj/tij:

a) kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli ose shkel detyrimet e përcaktuara në të;

b) kur rrethanat janë të tilla që s'do të kishte kuptim ose mundësi për ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;

c) në rast të moszbatimit të urdhërimeve brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;

ç) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik, që garantohet nga titulli përkatës apo legjislacioni në fuqi;

d) kur titullari dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është licencuar/autorizuar apo që cenon jetën dhe shëndetin e njeriut;

dh) kur titullari gjatë ushtrimit të veprimtarisë për të cilën është licencuar/autorizuar shkel rregullat teknike, duke rrezikuar jetën e njerëzve, kafshëve dhe/ose mjedisit.

3. Ministritë e ngarkuara sipas nenit 21 të këtij ligji, në bazë të aplikimit të kërkuesit, i japin licencën ose autorizimin përkatës në mbështetje të kritereve të kualifikimit profesional dhe të gjendjes shëndetësore e gjyqësore të administratorit/drejtuesit teknik të personit fizik/juridik, që ka vendbanimin/selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Licencat dhe autorizimet e dhëna nuk u transferohen personave të tjerë.

5. Licencat, autorizimet dhe lejet e dhëna publikohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Neni 23
Regjistrimi i lëndëve plasëse

1. Prodhuesi dhe importuesi janë të detyruar t'i regjistrojnë lëndët plasëse që prodhojnë dhe i vendosin në treg në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Mbrojtjes mbahet regjistri shtetëror për lëndët plasëse. Dokumentet për aplikimin për regjistrim dhe mënyra e plotësimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

3. Prodhuesi dhe importuesi janë të detyruar të njoftojnë brenda 10 ditësh pune Ministrinë e Mbrojtjes për çdo ndryshim në të dhënat e aplikimit për regjistrim.

4. Të dhënat, publikimi i të cilave dëmton prodhuesin dhe importuesin, gjatë procesit të regjistrimit, me kërkesën e tyre, trajtohen sipas rregullimeve të kuadrit ligjor për "sekretin tregtar".

KREU VI
MBIKËQYRJA E TREGUT, KONTROLLI I LËNDËVE PLASËSE NË TREG, SI DHE PROCEDURA E MBIKËQYRJES

Neni 24
Autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut

1. Mbikëqyrja e tregut për zbatimin e këtij ligji bëhet nga:

a) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve gjatë prodhimit të lëndëve plasëse;

b) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe autoritetet doganore gjatë importit të lëndëve plasëse;

c) struktura përgjegjëse në ministrinë për çështjet minerare gjatë magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të lëndëve plasëse;

ç) organe të tjera mbikëqyrëse dhe inspektuese, secila në përputhje me kompetencat e veta.

2. Këto struktura në mënyrë individuale ose në bashkëpunim kryejnë inspektimet për të verifikuar përputhshmërinë e lëndëve plasëse dhe përmbushjen e kritereve e të kërkesave të këtij ligji, sipas ligjit për inspektimin.

3. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që lënda plasëse mund të vendoset në treg vetëm nëse do të ruhet në mënyrë të përshtatshme dhe do të përdoret për qëllimin e prodhuar dhe kur nuk rrezikon shëndetin e sigurinë e personave.

Neni 25
Procedura për trajtimin e lëndëve plasëse që paraqesin rrezik kombëtar

1. Kur autoritetet e mbikëqyrjes së tregut kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se lënda plasëse paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave, mallrave ose mjedisit, autoritetet duhet të bëjnë një vlerësim të lëndës plasëse, duke analizuar të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë ligj.

2. Operatorët përkatës ekonomikë duhet të bashkëpunojnë me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për këtë qëllim nëse është e nevojshme.

3. Në rast se autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, gjatë vlerësimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, konstaton se lënda plasëse nuk përmbush kërkesat e përcaktuara sipas këtij ligji, ai i kërkon menjëherë operatorit përgjegjës të marrë të gjitha masat korrigjuese të domosdoshme për ta sjellë

lëndën plasëse në përputhje me këto kërkesa ose të tërheqë lëndën plasëse nga tregu brenda 20 ditësh, në përputhje me natyrën e rrezikut, të përcaktuar nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

4. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut informon autoritetet licencuese në lidhje me masat e marra.

5. Në rast se autoritetet e mbikëqyrjes së tregut konstatojnë se mospërputhja nuk kufizohet vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, ato njoftojnë edhe shtetet e tjera/autoritetet homologe për rezultatet e vlerësimit dhe për veprimet që i kanë kërkuar operatorit ekonomik të ndërmarrë.

6. Operatori ekonomik siguron marrjen e të gjitha masave korrigjuese në lidhje me lëndët plasëse, të cilat i ka vendosur në treg.

7. Në rast se operatori përkatës ekonomik nuk merr masat e duhura korrigjuese brenda periudhës së përmendur në pikën 3 të këtij neni, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr masat e nevojshme provizore për të ndaluar ose kufizuar lëndën plasëse që vendoset në treg, tërheq lëndën plasëse nga tregu ose e rikthen atë.

8. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut informon institucionet përgjegjëse licencuese në kuptim të këtij ligji për masat e marra.

Informacioni i referuar në pikën 8 të këtij neni përfshin:

a) të dhënat e nevojshme për identifikimin e lëndës plasëse, e cila nuk plotëson kriteret;

b) origjinën e lëndës plasëse;

c) natyrën e mosplotësimit të pretenduar dhe rrezikun e përfshirë;

ç) natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të marra;

d) argumentet e parashtruara nga operatori ekonomik përkatës.

9. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut shprehet nëse mospërputhja është për shkak të:

a) mospërmbushjes së kërkesave të lëndës plasëse mbi kërkesat lidhur me shëndetin dhe sigurinë e personave apo aspektet e tjera të interesit të mbrojtjes së mallrave apo mjedisit;

b) mospërmbushjes së standardeve të harmonizuara, të cilat i japin prezumimin e përputhshmërisë.

10. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, i cili fillon procedurën sipas këtij neni, informon menjëherë institucionet licencuese, sipas këtij ligji, si dhe operatorin ekonomik për çdo masë të marrë dhe për çdo informacion shtesë në lidhje me lëndën plasëse, e cila nuk përmbush kriteret e përputhshmërisë.

11. Në rast se operatori ekonomik nuk është dakord me masën e marrë, paraqet kundërshtimet me shkrim pranë autoritetit mbikëqyrës, që ka marrë masën, brenda 15 ditësh nga njoftimi i masës.

12. Në rast se brenda tre muajve nga marrja e informacionit të mësipërm nuk ngrihet asnjë kundërshtim nga operatorët ekonomikë në lidhje me masën e përkohshme të marrë nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, kjo masë konsiderohet e ligjshme.

13. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut sigurohen që masa kufizuese e tërheqjes së lëndës plasëse nga tregu të zbatohet pa vonesë.

14. Në rast se në përfundim të procedurës ngrihen kundërshtime lidhur me masat e marra nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut ose në rastin kur masat e marra bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut bashkëpunon me operatorët ekonomikë për vlerësimin e masave të marra.

15. Në rast se vlerësimet e konstatuara qëndrojnë, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr masat për të siguruar tërheqjen e lëndës plasëse nga tregu.

16. Në rast se vlerësimet e konstatuara nuk qëndrojnë, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut tërheq masën e marrë.

Neni 26

Lëndët plasëse të përputhshme, por që paraqesin rrezik

1. Në rastin e kryerjes së vlerësimit sipas parashikimeve në pikën 1 të nenit 25 të këtij ligji, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut konstaton se lënda plasëse është në përputhje me parashikimet e këtij ligji, por paraqet rrezik për shëndetin, sigurinë e njerëzve, mallrave ose mjedisit, atëherë i kërkon operatorit ekonomik përgjegjës:

a) të marrë të gjitha masat për të siguruar që lënda plasëse në fjalë në momentin e hedhjes në treg nuk paraqet rrezik ose;

b) të tërheqë lëndën plasëse nga tregu ose;

c) të rikthejë ose të ndalojë tregtimin e lëndës plasëse në një afat kohor të arsyeshëm, në raport me natyrën e rrezikut të përcaktuar nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

2. Operatorët ekonomikë duhet të garantojnë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të gjitha lëndët plasëse që janë hedhur në treg.

3. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut jep informacionet, të cilat duhet të përfshijnë të gjitha të dhënat e disponueshme, veçanërisht detaje të domosdoshme për identifikimin e lëndës plasëse, origjinën, zinxhirin e furnizimit të lëndës plasëse, natyrën e rrezikut të përfshirë, natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të marra.

4. Operatorët ekonomikë marrin pjesë në konsultimet për konstatimet, me qëllim vlerësimin nga ata të masave të marra nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

Neni 27

Rregullimi i mospërputhshmërisë

1. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut i kërkon operatorit ekonomik të rregullojë mospërputhshmërinë kur konstaton se:

a) markimi CE është vendosur në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji;

b) markimi CE nuk është vendosur;

c) numri i identifikimit të autoritetit akreditues në rastet kur ai organ është i përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit, është dhënë në kundërshtim me këtë ligj ose nuk është dhënë fare;

ç) nuk është hartuar deklarata e përputhshmërisë së BE-së;

d) deklarata e përputhshmërisë së BE-së nuk është hartuar në mënyrë të saktë;

dh) dokumentacioni teknik ose nuk është i disponueshëm ose është i paplotë;

e) dokumentacioni i parashikuar në lidhje me gjurmimin ose kriteret e sigurisë mungon, është i rremë apo i paplotë;

ë) nuk janë plotësuar parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 4 ose nenin 6 të këtij ligji.

2. Në rast se mospërputhshmëria e parashikuar në pikën 1 të këtij neni vazhdon, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar apo ndaluar hedhjen në treg të lëndës plasëse ose për t'u siguruar që kjo lëndë të tërhiqet nga tregu.

Neni 28

Ndalimi i tregtimit të produkteve dhe bllokimi

1. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut mund të vendosë të ndalojë përkohësisht hedhjen e produktit në treg në rastet kur:

a) ka dyshime se produkti nuk përmbush kërkesat thelbësore ose kërkesat e tjera të sigurisë së lëndës plasëse;

b) produkti nuk ka markën CE ose është markuar në mënyrë të paligjshme dhe/ose nuk është shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm ndaj këtij produkti;

c) operatorët ekonomikë nuk kanë përmbushur masat e urdhëruara brenda afatit kohor të vendosur nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut dhe produkti mund të paraqesë rrezik për përdoruesin e fundit;

ç) prodhimi, magazinimi, përdorimi apo tregtimi mund të paraqesë rrezikshmëri;

d) autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në vende të tjera të BE-së kanë njoftuar se produkti është i rrezikshëm dhe/ose jo në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara për produktin.

2. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut shfuqizon vendimin për ndalimin e përkohshëm të tregtimit kur operatori ekonomik vërteton se ai plotëson kushtet e parashikuara nga ky ligj.

3. Vendimi i ndalimit të përkohshëm mund të shoqërohet, nëse është e nevojshme, me detyrimin e operatorit ekonomik për lajmërimin e përdoruesit të fundit për rrezikun.

4. Struktura përgjegjëse urdhëron ndalimin e përhershëm të tregtimit në qoftë se kontrollet ose testimet provojnë se lënda plasëse paraqet rrezik dhe nuk është në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë ose, pavarësisht përputhshmërisë, lënda plasëse mund të rrezikojë jetën, shëndetin, mjedisin ose interesat e tjerë publikë.

5. Vendimi për ndalimin e tregtimit mund të merret nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut në qoftë se:

a) të njëjtat masa janë marrë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, ku është tregtuar produkti;

b) prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi ka njoftuar se produkti është i rrezikshëm ose nuk është në përputhje me legjislacionin përkatës.

6. Vendimi shoqërohet me një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) lajmërimin e tregtarëve/përdoruesve të fundit, duke përdorur mjetet e përshtatshme të komunikimit publik për rrezikun që paraqet lënda plasëse;

b) urdhërimin për ndalimin e menjëhershëm të tregtimit në qoftë se produkti është tashmë në treg ose kthimin mbrapsht të tij;

c) urdhërimin e bërjes jofunksionale të lëndës plasëse ose asgjësimin e saj.

7. Lajmërimi i klientëve dhe i përdoruesve të fundit dhe kthimi i lëndës plasëse duhet të kryhen nga operatorët ekonomikë nën mbikëqyrjen e autoritetit të mbikëqyrjes së tregut.

8. Në rast se masat e marra nga operatorët ekonomikë konsiderohen si të pamjaftueshme, veprimet e sipërpërmendura kryhen nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut dhe shpenzimet mbulohen nga operatori ekonomik përgjegjës.

9. Asgjësimi i produktit ose bërja jofunksionale kryhet nga operatori ekonomik ose nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi për ndikimin në mjedis dhe shpenzimet mbulohen nga operatori ekonomik përgjegjës.

10. Rregullat dhe procedurat e asgjësimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë.

Neni 29

Inspektimi

1. Gjatë inspektimit nëpunësit e strukturave të mbikëqyrjes së tregut, të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji, sipas fushave të kompetencës janë të autorizuar të kryejnë pa njoftuar paraprakisht operatorin ekonomik, subjekt i inspektimit, veprimet e mëposhtme:

a) inspektimin e strukturave, hapësirave dhe shesheve të ndërtimit ku prodhohen, ruhen, përdoren, asgjësohen ose shiten lëndë plasëse, si dhe të hapësirave të tjera që dyshohen se ruajnë lëndë plasëse;

b) kontrollin e dokumentacionit për lëndët plasëse dhe kualifikimet teknike të personave;

c) verifikimin dhe përcaktimin e identitetit të personave që gjenden në vendet ku përdoren, prodhohen dhe ruhen lëndë plasëse;

ç) kryerjen e aktiviteteve të tjera në përputhje me qëllimin e mbikëqyrjes inspektuese.

2. Nëpunësit e përmendur në pikën 1 të këtij neni kryejnë inspektimin në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

3. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, që ka kryer kontrollin, merr vendim në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

Neni 30
Ankimi

Kundër vendimit lejohet ankim në gjykatën kompetente brenda një afati prej 20 ditësh, duke nisur nga dita e njohjes me vendimin e arsyetuar.

Neni 31
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga operatorët ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1.1 Gjobitet me 200 000 (dyqind mijë) – 500 000 (pesëqind mijë) lekë operatori ekonomik, i cili:

a) përfshihet në testimin e lëndëve plasëse ose aktivitetet e specializuara në procesin e vlerësimit të përputhshmërisë pa licencë/autorizim nga struktura përgjegjëse;

b) prodhon ose tregton lëndë plasëse, të cilat nuk janë testuar dhe markuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

Për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1.1 të këtij neni dhe që përsëriten gjatë një periudhe dyvjeçare, krahas gjobës mund të vendoset edhe masa mbrojtëse e pezullimit për një vit të aktivitetit që ka çuar në kundërvajtje.

1.2 Gjobitet me 100 000 (njëqind mijë) - 200 000 (dyqind mijë) lekë operatori ekonomik, i cili:

a) nuk miraton një rregullore të përgjithshme që të përmbajë planin e veprimit për masat e sigurisë ose nuk vepron në përputhje me këtë rregullore;

b) nuk ua njofton masat e parashikuara në rregullore të gjithë personave që kryejnë aktivitetet me lëndë plasëse për llogari të tij, ose nuk u ofron atyre trajnimin për të vepruar në rast aksidenti;

c) nuk garanton mbrojtje të përhershme fizike ose teknike të ambienteve për prodhimin ose magazinimin e lëndëve plasëse;

ç) lejon përdorimin e lëndëve plasëse nga persona pa kualifikim teknik;

d) lejon një person, i cili nuk është i kualifikuar teknikisht, nuk zotëron vërtetim të aftësisë, nuk punon nën mbikëqyrjen e personit përgjegjës teknikisht të kualifikuar dhe nuk ka deklaruar me shkrim se i njeh rreziqet dhe rregullat e sigurisë në vendin e punës, të përfshihet në aktivitete ndihmëse për prodhimin, tregtimin, transportimin, magazinimin ose përdorimin e lëndëve plasëse;

dh) gjatë ekzaminimit të lëndëve plasëse, laboratori i akreditуar zbulon se ato nuk përmbushin kërkesat teknike, por nuk ia raporton këtë fakt autoritetit përkatës që lëshon licencën e prodhimit;

e) magazinon lëndë plasëse në struktura dhe ambiente që nuk janë krijuar për magazinimin e lëndëve plasëse ose i magazinon ato në sasi që tejkalojnë kapacitetin maksimal të magazinës;

ë) magazinon në magazinën e përkohshme lëndë plasëse që tejkalojnë kapacitetin maksimal ose lëndët plasëse të ruajtura në magazinën e përkohshme i përdor për aktivitete që nuk lidhen me objektin për të cilin është ndërtuar magazina;

f) zotëron licencë për prodhimin/importimin/eksportimin e lëndëve plasëse dhe u shet lëndë plasëse personave juridikë dhe sipërmarrësve të cilët nuk kanë licencë/autorizim përkatës për përdorim/shpërndarje/magazinim;

g) transferon lëndë plasëse pa autorizim;

gj) është përgjegjës për mbajtjen e të dhënave për gjurmimin e lëndëve plasëse dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore;

h) angazhohet në transportin e lëndëve plasëse duke mos respektuar rregulloret për transportin e lëndëve plasëse;

i) nuk merr të gjitha masat e sigurisë gjatë operacioneve të minimit dhe nuk i kryen ato operacione në përputhje me planin e minimit;

j) pengon inspektorin që të kryejë mbikëqyrjen inspektuese ose nuk i siguron atij akses në dokumentacionin e kërkuar dhe/ose nuk i jep informacionin dhe të dhënat e nevojshme.

Për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1.2 të këtij neni, që përsëriten gjatë një periudhe dyvjeçare, krahas gjobës mund të vendoset edhe masa plotësuese e pezullimit të aktivitetit që ka çuar në kundërvajtje për 6 muaj.

1.3 Gjobitet me 10 000 (dhjetë mijë) – 100 000 (njëqind mijë) lekë operatori ekonomik, i cili:

a) pas përdorimit të lëndës plasëse nuk kujdeset për ambalazhin e lëndëve plasëse në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;

b) ambalazhin e synuar për paketimin e lëndëve plasëse e përdor për qëllime të tjera;

c) nuk e njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë për humbjen ose vjedhjen e lëndëve plasëse;

ç) nuk njofton strukturat përgjegjëse që kanë lëshuar licencat/autorizimet për ndërprerjen e aktiviteteve të lejuara nga ky ligj apo ndryshime të tjera në status dhe kushtet dhe kriteret me të cilat është përfituar licenca/autorizimi, brenda tetë ditëve nga data e ndodhjes së tyre;

d) nuk u dorëzon strukturave përkatëse të dhënat e shtetasit që synon të angazhojë në kryerjen e aktiviteteve në lidhje me lëndët plasëse;

dh) transferon dhe përdor lëndë plasëse në ambalazh që nuk është testuar dhe markuar në përputhje me rregulloret që rregullojnë transportin e mallrave të rrezikshme dhe rregulloret për markimin e lëndëve plasëse;

e) nuk mban të dhëna për dokumentacionin teknik, deklaratat e përputhshmërisë, sistemin e gjurmimit sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj;

ë) nuk raporton pranë strukturave përgjegjëse, të cilat kanë miratuar licencat/autorizimet sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj ose akteve nënligjore në zbatim të tij;

f) nuk ia kthen lëndët plasëse prodhuesit ose nuk i shkatërron ato me shpenzimet e tij brenda 30 ditëve nga data e njoftimit për pezullimin e tregtimit dhe përdorimit të lëndëve plasëse;

g) zotëron lëndë plasëse për të cilat ka dijeni se nuk janë në përputhje me kërkesat teknike dhe me strukturën përkatëse;

gj) strukturat për prodhimin dhe magazinimin e lëndëve plasëse nuk janë ndërtuar dhe nuk kanë pajisjet e duhura për të siguruar mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, pronës së tyre dhe mjedisit;

h) magazinon lëndë plasëse në magazina të përkohshme për ndërtimin dhe shfrytëzimin e të cilave nuk është marrë autorizimi përkatës;

i) nuk i dorëzon strukturës përgjegjëse të dhënat e mbajtura në përputhje me këtë ligj, brenda tetë ditësh nga data e marrjes së vendimit që shfuqizon licencën për prodhimin e lëndëve plasëse;

j) magazinon lëndët plasëse të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji në sasi që tejkalojnë kapacitetin e disponueshëm të magazinës;

k) nuk njofton strukturën përgjegjëse në rast ndryshimesh në lidhje me transportin e njoftuar të lëndëve plasëse menjëherë pas marrjes dijeni për këtë fakt;

l) nuk njofton strukturën përgjegjëse për çdo transferim të lëndëve plasëse, sipas vendit të pikës së nisjes së transportit ose sipas vendit të pikës së kalimit të hyrjes dhe/ose daljes, jo më vonë se 24 orë përpara nisjes së transportit;

ll) përdor lëndë plasëse dhe nuk i kthen lëndët plasëse të papërdorura në magazinë me paketimin e tyre fillestar ose nuk i asgjëson ato në përputhje me specifikimet e prodhuesit, në mënyrë që ato të mos vënë në rrezik jetën, shëndetin e njerëzve dhe sigurinë e pronave dhe të mjedisit.

Për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1.3 të këtij neni, që përsëriten gjatë një periudhe dyvjeçare, krahas gjobës mund të vendoset edhe masa plotësuese e pezullimit të aktivitetit që ka çuar në kundërvajtje për 6 muaj.

2. Shkeljet me karakter administrativ konstatohen nga struktura përgjegjëse, e përcaktuar në pikën 1 të nenit 24 të këtij ligji, sipas fushës së kompetencës.

3. Ankimi ndaj vendimit për dhënien e gjobës bëhet sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative brenda 30 ditëve pranë ministrit përgjegjës. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit për dhënien e gjobës.

4. Të ardhurat që burojnë nga vjelja e gjobave kalojnë në buxhetin e shtetit.

KREU VII

Neni 32
Dispozita kalimtare

1. Për procedurat e licencimit, kontrollit, raportimeve të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Licencat, lejet, autorizimet, të cilat janë lëshuar në bazë të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, do të mbeten në fuqi deri në 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Brenda këtij afati operatorët duhet të marrin masat për licencim sipas këtij ligji dhe duhet të përmbushin dispozitat që parashikon ky ligj për sigurinë e lëndëve plasëse.

Neni 33
Aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton aktet e përcaktuara në pikën 6 të nenit 14, në pikën 1 të nenit 22 dhe në pikën 10 të nenit 28 të këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për energjinë dhe industrinë minerare miraton brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji aktet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 13 të këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për transportet miraton brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji aktin e përcaktuar në pikën 4 të nenit 13 të këtij ligji.

4. Ministri i Mbrojtjes, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë dhe ministri përgjegjës për industrinë minerare miratojnë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji aktet e përcaktuara në pikën 12 të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 34
Shfuqizime

1. Ligji nr. 9126, datë 29.7.2003, "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 35
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.6.2021.

SHTOJCA I
ARTIKUJT QË KONSIDEROHEN SI PIROTEKNIKË OSE MUNICIONE NË BAZË TË REKOMANDIMEVE PËRKATËSE TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Nr. i OKB-së	Emri dhe përshkrimi	Klasa/kategoria	Fjalor (për t'u përdorur si udhëzues vetëm për informacion)
Grupi G			
0009	Municione zjarrvënëse me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.2 G	Municione. Term i përgjithshëm që lidhet kryesisht me artikujt e përdorimit ushtarak, të përbërë nga të gjitha llojet e bombave, granatave, raketave, minave, predhave dhe pajisjeve të tjera të ngjashme. Municione zjarrvënëse. Municione që përmbajnë substanca zjarrvënëse. Me përjashtim të rasteve kur përbërja është në vetvete një lëndë plasëse, kur gjithashtu përmban një ose më tepër nga sa vijon: një ngarkesë shtytëse me kapsollë dhe lëndën ndezëse; një kapsollë me shpërthyes ose mbushje nxjerrëse.
0010	Municione zjarrvënëse me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0009.
0015	Municione tymuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.2 G	Municione tymuese. Municionet që përmbajnë substanca që prodhojnë tym. Me përjashtim të rasteve kur substanca është në vetvete një lëndë plasëse, kur municioni gjithashtu përmban një ose më tepër nga sa vijon: një ngarkesë shtytëse me kapsollë dhe lëndën ndezëse; një kapsollë me shpërthim ose mbushje nxjerrëse.
0016	Municione tymuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0015.
0018	Municione lotsjellëse me shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.2 G	Municione lotsjellëse me shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse. Municione që përmbajnë substanca lotsjellëse. Gjithashtu përmban një ose më tepër nga sa vijon: një substancë piroteknike, një ngarkesë shtytëse me kapsollë dhe lëndën ndezëse; një kapsollë me shpërthim ose mbushje nxjerrëse.
0019	Municione lotsjellëse me shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0018.
0039	Bomba verbuese.	1.2 G	Bomba. Artikuj plasës që hidhen nga mjete fluturuese. Ato mund të përmbajnë një lëng të ndezshëm me ngarkesë shpërthyese, një përbërje verbuese ose një ngarkesë shpërthyese. Termi përfshin: bomba verbuese.
0049	Fishekë ndriçues.	1.1 G	Fishekë ndriçues. Artikuj që përbëhen nga një veshje e jashtme, një kapsollë dhe baruti ndriçues, të gjitha të bashkuara në një pjesë të vetme dhe të gatshme për qitje.
0050	Fishekë ndriçues.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0049.
0054	Fishekë sinjalizues.	1.3 G	Fishekë sinjalizues. Artikuj të projektuar për të qëlluar sinjalizues të shndritshëm me

			ngjyra ose sinjale të tjera nga pistoletat sinjalizuese etj.
0066	Fitil ndezës.	1.4 G	Fitil ndezës. Artikuj të përbërë nga fije tekstili të mbuluara me barut të zi ose me një tjetër përbërje piroteknike me djegie të shpejtë dhe nga një mbulesë mbrojtëse e butë ose të përbërë nga një bërthamë baruti të zi e mbështjellë nga një pëlhurë e butë: Ai digjet pandalshëm përgjatë gjatësisë së tij me një flakë të jashtme dhe përdoret për të transmetuar ndezjen nga një pajisje te një ngarkesë.
0092	Sinjalizues sipërfaqësor.	1.3 G	Artikuj sinjalizues që përmbajnë substanca piroteknike, të cilat janë të projektuara për t'u përdorur për të ndriçuar, identifikuar, sinjalizuar ose paralajmëruar.
0093	Sinjalizues ajror.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0101	Kapsolla jodetonuese.	1.3 G	Fuse/Fuze (kapsolla/siguresa). Edhe pse këto dy fjalë kanë një origjinë të përbashkët (frëngjisht fusée, fusil) dhe ndonjëherë konsiderohen thjesht si germëzime të ndryshme, duhet të ruhet *konvencioni që "fusë", i referohet një pajisjeje ndezëse të ngjashme me fitilin, ndërsa "fuzë" i referohet një pajisjeje* që përdoret në municione që përfshijnë përbërës mekanikë, elektrikë, kimikë ose hidrostatikë për të ndezur me shpërthim ose djegie. Kapsolla të çastit jodetonuese (me ndezje të shpejtë). Artikull i përbërë nga fije pambuku të ngopura me barut të imët të zi (me ndezje të shpejtë). Digjet me flakë të jashtme dhe përdoret në zinxhirët e ndezjes për fishekzjarrë etj.
0103	Kapsolla ndezëse të veshura me metal.	1.4 G	Kapsolla ndezëse të veshura me metal. Artikull i përbërë nga një tub prej metali me një bërthamë me lëndë plasëse shpërthyese.
0171	Municione ndriçuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.2 G	Municione ndriçuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse. Municione të ndërtuara për të prodhuar një burim drite intensive për ndriçimin e një zone. Termi përfshin fishekët ndriçues, granatat dhe predhat; dhe bombat ndriçuese dhe me identifikim objektivi.
0191	Pajisje sinjalistike të dorës.	1.4 G	Artikuj të ndërtuar për prodhimin e sinjaleve.
0192	Sinjale shpërthyese për trasenë hekurudhore.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0194	Sinjale rreziku për anije.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0195	Sinjale rreziku për anije.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0196	Sinjale tymi.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0197	Sinjale tymi.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0212	Gjurmues për municione.	1.3 G	Gjurmues për municione. Artikuj të izoluar që përmbajnë substanca piroteknike, të projektuara për të zbuluar trajektoren e një predhe.
0254	Municione ndriçuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0171.
0297	Municione ndriçuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0254.
0299	Bomba verbuese.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0039.
0300	Municione zjarrvënëse me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0009.

0301	Municione lotsjellëse me shpërthyes, mbushje nxjerrëse.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0018.
0303	Municione tymuese me ose pa shpërthyes me mbushje nxjerrëse.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0015.
0306	Gjurmues për municione.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0212.
0312	Fishekë sinjalizues.	1.4 G	Fishekë sinjalizues. Artikuj të projektuar për të qëlluar sinjalizues të shndritshëm me ngjyra ose sinjale të tjera nga pistoletat sinjalizuese.
0313	Sinjale tymi.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0195.
0318	Granata dore ose pushkë për praktikë.	1.3 G	Granata dore ose pushkë. Artikuj të projektuar për t'u hedhur me dorë ose me pushkë. Termi përfshin: granata dore ose pushkë për praktikë.
0319	Ndezësit tubularë.	1.3 G	Ndezësit tubularë. Artikuj që përbëhen nga një ndezës dhe një mbushje ndihmëse lënde shpërthyese djegëse si pluhur i zi, që përdoret për të ndezur mbushjen hedhëse në një fole fisheku, p.sh.: top.
0320	Ndezësit tubularë.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0319.
0333	Fishekzjarrë.	1.1 G	Fishekzjarrë. Artikuj piroteknikë të projektuar për argëtim.
0334	Fishekzjarrë.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0333.
0335	Fishekzjarrë.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0333.
0336	Fishekzjarrë.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0333.
0362	Municione për praktikë.	1.4 G	Municione për praktikë Municione pa mbushje kryesore shpërthyese, që përmban një mbushje shpërthyese ose nxjerrëse. Normalisht përmban një siguresë dhe një mbushje shtytëse.
0363	Municione prove.	1.4 G	Municione prove. Municione që përmbajnë substanca piroteknike të përdorura për të testuar performancën ose fuqinë e municioneve të reja, përbërësve të armëve apo kompleteve.
0372	Granata dore ose pushkë për praktikë.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0318.
0373	Pajisje sinjalistike të dorës.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0403	Sinjalizues ajrorë.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0418	Sinjalizues sipërfaqësorë.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0419	Sinjalizues sipërfaqësorë.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0420	Sinjalizues ajror.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0421	Sinjalizues ajror.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0424	Predha inerte me gjurmues.	1.3 G	Predha. Artikuj, si gëzhoja ose plumba të cilët hidhen nga një top apo armë artilerie, pushkë apo armë të tjera të vogla. Ato mund të jenë inerte, me ose pa gjurmues, ose mund të përmbajnë një mbushje nxjerrëse ose shpërthyese. Termi përfshin: Predhat inerte me gjurmues; predhat me mbushje shpërthyese ose nxjerrëse; predha me mbushje shpërthyese.
0425	Predha inerte me gjurmues.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0424.
0428	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike.	1.1 G	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike. Artikuj që përmbajnë substanca piroteknike dhe që përdoren për qëllime teknike si gjenerues nxehtësie, gjenerues gazi, efekte teatrore

			etj. Termi përjashton artikujt vijues të cilët listohen veçmas: të gjithë municionet, fishekët sinjalizues, prerës shpërthyes kabllosh, fishekzjarrët, sinjalizuesit ajror, sinjalizuesit sipërfaqësorë, pajisje shkëputëse shpërthyese, përçin shpërthyes, pajisje sinjalizuese dore, sinjalizues rreziku, sinjalizues hekurudhorë shpërthyes, sinjale tymuese.
0429	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0428.
0430	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0428.
0431	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0428.
0434	Predha me mbushje shpërthyese ose nxjerrëse.	1.2 G	Predha. Artikuj, si gëzhoja ose plumba të cilët hidhen nga një top apo armë artilerie, pushkë apo armë të tjera të vogël. Ato mund të jenë inerte, me ose pa gjurmues, ose mund të përmbajnë një mbushje nxjerrëse ose shpërthyese. Ky term përfshin: predhat inerte me gjurmues; predhat me mbushje shpërthyese ose nxjerrëse; predha me mbushje shpërthyese.
0435	Predha me mbushje shpërthyese ose nxjerrëse.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0434.
0452	Granata dore ose pushkë për praktikë.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0372.
0487	Sinjale tymuese	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0194.
0488	Municione për praktikë.	1.3 G	Municione për praktikë Municione pa mbushje kryesore shpërthyese, që përmban një mbushje shpërthyese ose nxjerrëse. Normalisht përmban një siguresë dhe një mbushje shtytëse. Termi nuk përfshin artikujt e mëposhtëm të cilët listohen më vete: Granata për praktikë.
0492	Sinjale shpërthyese për trasenë hekurudhore.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0194.
0493	Sinjale shpërthyese për trasenë hekurudhore.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0194.
0503	Fryrës për jastëkë ajri ose module për jastëkë ajri ose paratendosës të rripave të sigurimit.	1.4 G	
Grupi S			
0110	Granata dore ose pushke për praktikë.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0318.
0193	Sinjale shpërthyese për trasenë hekurudhore.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0194.
0337	Fishekzjarrë.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0334.
0345	Predha inerte me gjurmues.	1.4 S	Predha. Artikuj, si gëzhoja ose plumba, të cilët hidhen nga një top apo armë artilerie, pushkë apo armë të tjera të vogël. Ato mund të jenë inerte, me ose pa gjurmues, ose mund të përmbajnë një mbushje nxjerrëse ose shpërthyese.
0376	Ndezësit tubularë.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0319.
0404	Sinjalizues ajror.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0405	Fishekë sinjalizues.	1.4 S	Fishekë sinjalizues. Artikuj të projektuar për të qëlluar sinjalizues të shndritshëm me ngjyra ose sinjale të tjera nga pistoletat sinjalizuese etj.
0432	Artikuj piroteknikë ose për qëllime teknike.	1.4 S	

SHTOJCA II
KRITERET KRYESORE TË SIGURISË

I. Kriteret e përgjithshme

1. Çdo lëndë plasëse duhet të projektohet, prodhohet dhe furnizohet në atë mënyrë që të paraqesë rrezik minimal ndaj sigurisë së jetës së njeriut dhe shëndetit dhe të parandalojë dëmet ndaj pronës dhe mjedisit në kushtet normale dhe të parashikueshme, sidomos në lidhje me rregullat dhe praktikat standarde të sigurisë deri në përdorimin e saj.

2. Çdo lëndë plasëse duhet të plotësojë karakteristikat e performancës që prodhuesi i ka specifikuar organit të notifikuar, me qëllimin për të garantuar siguri dhe besueshmëri maksimale.

3. Çdo lëndë plasëse duhet të projektohet dhe prodhohet në mënyrë të tillë që të mund të asgjësohet në mënyrë të sigurt nëpërmjet një procesi të qëndrueshëm me ndikim minimal në mjedis.

II. Kriteret e veçanta

1. Minimalisht, në rast se është mundur, duhet të merren në konsideratë apo testohen informacionet dhe veçoritë e mëposhtme:

a) dizajni, ndërtimi dhe veçoritë karakteristike, duke përfshirë përbërjen e hollësishme kimike, shkallën e homogjenitetit dhe në rast se është e mundur, edhe përmasat dhe shpërndarja e pjesëve të vogla;

b) qëndrueshmëria fizike dhe kimike e lëndës plasëse në të gjitha kushtet normale dhe të parashikueshme mjedisore ndaj të cilave mund të ekspozohet;

c) ndjeshmëria ndaj impaktit dhe fërkimit;

ç) pajtueshmëria e të gjithë komponentëve për sa i përket qëndrueshmërisë fizike dhe kimike të tyre;

d) pastërtia kimike e lëndëve plasëse;

dh) rezistenca e lëndëve plasëse ndaj ndikimit të ujit në rastet kur ajo synohet të përdoret në kushte me lagështi apo të njoma dhe në rast kur siguria apo besueshmëria e saj mund të ndikohet negativisht nga uji;

e) rezistenca ndaj temperaturave të ulëta dhe të larta në rastet kur lënda plasëse është parashikuar për t'u mbajtur ose përdorur në temperatura të tilla dhe kur siguria ose besueshmëria e tij mund të ndikohet negativisht nga ftohja ose nxehja e një përbërësi ose e lëndës plasëse në tërësi;

ë) përshtatshmëria e lëndëve plasëse që përdoren në mjedise të rrezikshme (p.sh.: atmosferë të nxehtë, masa të nxehta), nëse synohet të përdoret në kushte të tilla;

f) veçoritë e sigurisë të synuar për parandalimin e fillimit apo ndezjes së parakohshme dhe të paqëllimtë;

g) mbushjen dhe funksionimin e lëndëve shpërthyese në lidhje me trajtimin, ruajtjen, përdorimin dhe eliminimin e sigurt;

gj) udhëzimet e përshtatshme dhe, në rast nevoje, markimet në lidhje me trajtimin, ruajtjen, përdorimin dhe eliminimin e sigurt;

h) mundësinë e lëndës plasëse, paketimin apo komponentët e tjerë për të përballuar përkeqësimin gjatë ruajtjes deri në "përdorimin" në datën e specifikuar nga prodhuesi;

i) specifikimet për të gjitha pajisjet dhe aksesorët e nevojshëm për funksionim të besueshëm dhe të sigurt të lëndëve plasëse.

2. Çdo lëndë plasëse të testohet në kushte reale. Nëse kjo nuk është e mundur në një laborator, testet të kryhen në kushtet ku do të përdoret lënda plasëse.

3. Kriteret për grupet e lëndëve plasëse.

3.1 Lëndët plasëse detonuese duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) metoda e propozuar e fillimit duhet të sigurojë detonim të sigurt, të besueshëm dhe të plotë apo deflagracionin e duhur të lëndës shpërthyese që detonon. Sidomos në rastet e pluhurit të zi, përcaktues është kapaciteti në lidhje me deflagrimin;

b) lëndët plasëse detonuese në formë predhe duhet të kalojnë detonimin në mënyrë të sigurt dhe të besueshëm nga një anë e vargut të predhave të tjetra;

c) tymrat e prodhuar nga shpërthimi i lëndëve shpërthyese për përdorim nëntokësor mund të përmbajnë karbon monoksid, gaze nitrike, gazra të tjera, avuj apo mbetje të ngurta që fluturojnë vetëm në sasi që nuk dëmtojnë shëndetin në kushte normale të funksionimit.

3.2 Telat e detonimit, siguresat, siguresat e tjera dhe tubat e goditjes duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) mbulesa e telave detonuese, siguresat, siguresat e tjera dhe tubat e goditjes duhet të kenë fuqinë e duhur mekanike dhe të mbrojnë siç duhet mbushjen me lëndë shpërthyese kur ekspozohet në presion normal mekanik;

b) të paraqiten parametrat për kohën e djegies të siguresave dhe të plotësohen në mënyrë të besueshme;

c) telat detonues duhet të jenë në gjendje që të ndezin në mënyrë të besueshme, të kenë aftësi të mjaftueshme ndezëse dhe të përmbushin kriteret në lidhje me ruajtjen edhe në kushte të veçanta klimaterike.

3.3 Detonatorët (duke përfshirë detonatorët e vonesës) dhe reletë të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) detonatorët duhet të fillojnë në mënyrë të besueshme detonimin e lëndëve plasëse që synohen të përdoren me to në kushtet e parapara për përdorim;

b) konektorët e vonesës për telat e detonimi duhet të ndizen në mënyrë të besueshme;

c) kapaciteti i ndezjes nuk duhet të ndikohet negativisht nga lagështira;

ç) kohëzgjatja e vonesës së detonatorëve vonues duhet të jetë mjaftueshëm uniforme për të siguruar që mundësia për mbivendosje e kohës së vonesës të hapave kohorë është e parëndësishme;

d) karakteristikat elektrike të detonatorëve elektrikë duhet të paraqitet te paketimi (p.sh. jorrymë, rezistente);

dh) telat e detonatorëve elektrikë duhet të kenë izolim të mjaftueshëm dhe forcë mekanike duke përfshirë soliditetin e lidhjes te detonatori, duke marrë parasysh përdorimin e synuar.

3.4 Shtytësit dhe shtytësit e raketave të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) nuk duhet të shpërthejnë kur përdoren për qëllimin e tyre;

b) shtytësit, në rast nevoje (p.sh. ato me bazë nitroceluloze) duhet të stabilizohen kundër dekompozimit;

c) shtytësit e ngurtë të raketave, në formë të ngjeshur apo me derdhje, nuk duhet të përmbajnë asnjë çarje të paqëllimshme ose flluska gazi të cilat ndikojnë në mënyrë të rrezikshme në funksionimin e tyre.

SHTOJCA III
PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË

MODULI B
Kontrolli i tipit-EU

1. Kontrolli tip EU është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë ku një organ i miratuar kontrollon projektimin teknik të një lënde plasëse dhe verifikon dhe vërteton nëse projektimi teknik i asaj lënde plasëse plotëson kriteret e këtij ligji për rastet kur ajo përdoret.

2. Kontrolli tip EU kryhet si një vlerësim për përshtatshmërinë e projektimit teknik të lëndës plasëse përmes kontrollit të dokumentacionit teknik dhe evidencës mbështetëse të parashikuar në

pikën 3, si edhe kontrollin e mostrës, përfaqësuesit të produktit të parashikuar, kontrollin e të gjithë produktit (kombinimin e llojit të produktit me llojin e projektimit).

3. Aplikimi për kontrollin tip EU duhet të paraqitet nga prodhuesi te një organ i miratuar, i zgjedhur prej tij.

Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit, nëse aplikimi është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, emri i tij dhe adresa;

b) një deklaratë me shkrim ku thuhet se i njëjti aplikim nuk është paraqitur te ndonjë organ tjetër i miratuar;

c) dokumentacioni teknik.

Dokumentacioni teknik duhet të mundësojnë vlerësimin e përputhshmërisë së lëndës me kërkesat e aplikueshme të këtij ligji dhe duhet të përfshijë analizën dhe vlerësimin e duhur të riskut.

Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e aplikueshme dhe përfshin, për sa kohë që është relevante për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e lëndës plasëse.

Dokumentacioni teknik përmban, kur është e mundur, të paktën elementet e mëposhtme:

i. një përshkrim të përgjithshëm të lëndës plasëse;

ii. projektin konceptual, skicime të prodhimit dhe diagrame të komponentëve, nënkomplete, qarqe etj.;

iii. përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar skicimet dhe diagramet, si dhe funksionimin e lëndës plasëse;

iv. listën e standardeve të harmonizuara që zbatohen plotësisht ose pjesërisht, dhe në rast të mosaplikimit të standardeve, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për përmbushjen e kërkesave kryesore të sigurisë të këtij ligji, duke përfshirë specifikimet relevante teknike që janë aplikuar. Në raste të zbatimit të pjesshëm të standardeve të harmonizuara, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë aplikuar;

v. rezultatet e llogaritjeve të bëra në lidhje me projektin, kontrollet e kryera etj.;

vi. raportet e testit;

ç) mostrat përfaqësuese të produktit të paraparë. Organ i miratuar mund të kërkojë mostra të tjera, nëse nevojiten për të kryer programin e testimit;

d) evidenca mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes së projektimit teknik. Kjo evidencë mbështetëse përmend çdo dokument që është përdorur, sidomos në rastin kur standardet relevante të harmonizuara nuk janë aplikuar në mënyrë të plotë. Evidenca mbështetëse përfshin, në rastet e nevojshme, rezultatet e testeve, të kryera në përputhje me specifikimet e tjera relevante nga ana e laboratorit të prodhuesit apo nga ana e një laboratori tjetër testues në emër ose nën përgjegjësinë e tij.

4. Organi i miratuar për lëndën plasëse:

4.1 Kontrollon dokumentacionin dhe evidencën mbështetëse për të verifikuar përputhshmërinë e projektimit teknik të lëndës plasëse.

4.2 Për mostrën/mostrat verifikon nëse tipi/at janë prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe të identifikojë elementet që janë projektuar në përputhje me dispozitat e aplikueshme të standardeve përkatëse të harmonizuara, si dhe elementet që janë projektuar në përputhje me dispozitat specifikimet e tjera përkatëse teknike.

4.3 Kryen ose urdhëron kryerjen e kontrolleve dhe testeve për të kontrolluar nëse janë zbatuar siç duhet standardet e harmonizuara përkatëse, në rastet kur prodhuesi ka zgjedhur t'i zbatojë ato.

4.4 Kryen kontrolle dhe testime të përshtatshme ose i kryen ato për të kontrolluar nëse zgjidhjet e bëra nga prodhuesi, në rastet kur nuk janë aplikuar standardet relevante të harmonizuara, duke përfshirë edhe ato raste e specifikimeve të tjera relevante teknike të aplikuara, i plotësojnë ose jo kërkesat e sigurisë të këtij ligji.

4.5 Bie dakord me prodhuesin për vendin ku do të kryhen kontrollet dhe testet.

5. Organi i miratuar përpilon një raport vlerësues i cili regjistron veprimtarinë e bërë në përputhje me pikën 4 dhe rezultatet e tyre. Pa paragjykuar detyrimet e tij ndaj autoritetit njoftues, organi i miratuar lëshon përmbajtjen e atij raporti, të plotë ose të pjesshëm, vetëm me anë të marrëveshjes me prodhuesin.

6. Në rastet kur tipi plotëson dispozitat përkatëse të këtij ligji, që zbatohet për lëndët plasëse në fjalë, organi i miratuar duhet t'i japë aplikantit një certifikatë kontrolli tip EU.

7. Certifikata duhet të përmbajë emrin dhe adresën e prodhuesit, rezultatet e kontrollit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë dhe të dhënat e domosdoshme për identifikimin e tipit të miratuar. Certifikata e kontrollit të tipit EU mund të ketë një apo më shumë shtojca të bashkëngjitura.

Certifikata e kontrollit të tipit EU dhe shtojcat e saj përmbajnë të gjithë informacionin relevant për të mundësuar kontrollin e përputhshmërisë së lëndëve të prodhuara plasëse dhe atyre të ekzaminuara dhe të mundësojë kontrollin gjatë shërbimit.

Në rastet kur tipi nuk përmbush mjaftueshëm kërkesat e aplikueshme të këtij ligji, organ i miratuar refuzon lëshimin e certifikatës kontrolluese të tipit EU dhe informon aplikuesin për këtë gjë, duke dhënë hollësi dhe arsye për këtë refuzim.

8. Organi i miratuar duhet të jetë i informuar për çdo ndryshim të asaj që konsiderohet gjerësisht si moderne dhe që mund të tregojë se tipi i miratuar nuk mund të jetë më në përputhje me kërkesat e zbatueshme të këtij ligji dhe organ i miratuar përcakton nëse ndryshimet e tilla kërkojnë hetime të mëtejshme. Nëse është kështu, organi i miratuar duhet të informojë prodhuesin në mënyrën e duhur.

Prodhuesi informon organin e miratuar që mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën kontrolluese tip EU, për të gjitha modifikimet e artikullit të miratuar, që mund të cenojnë përputhshmërinë e lëndës plasëse me kërkesat kryesore të sigurisë të këtij ligji ose me kushtet për vlefshmërinë e kësaj certifikate. Modifikimet e tilla kërkojnë miratim të mëtejshëm në formën e një certifikate kontrolluese shtesë të tipit EU, përveç origjinales.

9. Çdo organ i miratuar duhet të informojë autoritetin e tij akreditues në lidhje me certifikatat e kontrollit tip EU dhe/ose çdo shtojcë që ka lëshuar apo dhe që në mënyrë periodike sipas kërkesës, në mënyrë që të vërë në dispozicion të autoriteteve të saj akredituese listën e certifikatave të tilla dhe/ose çdo shtojcë të refuzuar, pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organ i miratuar duhet të informojë organet e tjera të miratuara në lidhje me certifikatat e kontrollit tip EU dhe/ose çdo shtojcë që ka refuzuar, tërhequr, pezulluar ose kufizuar dhe, sipas kërkesës, në lidhje me certifikatat dhe/ose plotësimet e tyre të cilat i ka lëshuar.

Organ i miratuar mban një kopje të certifikatës së kontrollit tip EU, shtojcat dhe shtesat e tij, si dhe dosjen teknike, duke përfshirë dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi, deri në skadimin e vlefshmërisë së asaj certifikate.

10. Prodhuesi duhet të mbajë një kopje të certifikatës kontrolluese tip EU, shtojcat e saj dhe shtesa, së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve të vendit për një periudhë prej të paktën 10 vjet pas vendosjes në treg të lëndës plasëse në fjalë.

11. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqesë aplikimin të referuar në pikën 3 dhe përmbush detyrimet e parapara në pikat 7 dhe 8, me kusht që ato janë të specifikuara në mandat.

MODULI C2

Përputhshmëria me tipin e bazuar në kontrollin e prodhimit të brendshëm, si edhe kontrollet e mbikëqyrura të produktit në intervale të rastësishme kohore

1. Përputhshmëria me llojin, bazuar te kontrolli i brendshëm i prodhimit, si edhe kontrollet mbikëqyrëse të produktit në mënyrë rastësore, është pjesë e procedurës së vlerësimit të

përputhshmërisë me anë të së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e parapara në pikat 2, 3 dhe 4 dhe garanton e deklaron vetëm me përgjegjësinë e tij që lëndët plasëse në fjalë janë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit EU dhe përmbush kriteret e këtij ligji që zbatohet për to.

2. Prodhimi

Prodhuesi merr masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë që lëndët shpërthyese të prodhuara të përputhen me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe me kërkesat e këtij ligji që aplikohen për ato.

3. Kontrollet ndaj produktit

Organi i miratuar i zgjedhur nga prodhuesi kryen ekzaminime të lëndës në intervale jo të rregullta të përcaktuara nga organi për të kontrolluar cilësinë e kontrolleve të brendshme të lëndëve plasëse, duke marrë parasysh ndër të tjera, kompleksitetin teknologjik të lëndëve plasëse dhe sasinë e prodhimit. Për të kontrolluar përputhshmërinë e lëndës plasëse me certifikatën ekzaminuese tip EU dhe me kërkesat e këtij ligji, një mostër e përshtatshme e lëndës përfundimtare, e marrë në vendin e prodhimit nga organi i miratuar përpara se të dalë në treg, duhet të ekzaminohet dhe duhet të kryhen testet e përshtatshme të përcaktuara te specifikimet e tjera relevante. Në rast se një mostër nuk përputhet me nivelin e pranueshëm të cilësisë, organi merr masat e duhura.

Procedura që aplikohet për pranimin e mostrës ka për qëllim të përcaktojë nëse procesi i prodhimit të lëndës plasëse bëhet brenda kufijve të pranueshëm, duke pasur parasysh sigurimin e përputhshmërisë me lëndën plasëse.

Gjatë procesit të prodhimit, prodhuesi, nën përgjegjësinë e organit të miratuar, duhet të vendosë numrin e identifikimit të organit të miratuar.

4. Markimi CE dhe deklarata e përshtatshmërisë së BE-së

4.1 Prodhuesi bën markimin CE për secilën lëndë plasëse që është në përputhje me tipin e paraparë në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e aplikueshme të këtij ligji.

Prodhuesi përpilon një deklaratë CE me shkrim për përputhshmërinë e secilës lëndë plasëse dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet që nga vendosja në treg e lëndës plasëse. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon lëndën plasëse për të cilën ajo është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve relevante, në vijim të kërkesës.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandat.

MODULI D
Përputhshmëria me tipin e bazuar në garantimin e cilësisë së procesit të prodhimit

1. Përputhshmëria me tipin e bazuar në cilësinë e procesit të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2 dhe 5 dhe siguron e deklaron me përgjegjësi vetëm të tij se lëndët plasëse në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji që aplikohen për ato.

2. Prodhimi

Prodhuesi përdor një sistem të miratuar cilësie për inspektimin dhe testimin e lëndëve përkatëse plasëse, siç specifikohet në pikën 3 dhe ai i nënshtrohet monitorimit të përmendur në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

3.1 Prodhuesi i paraqet organit të miratuar, të zgjedhur prej tij, një aplikim për vlerësimin e sistemit të cilësisë për lëndët e tij plasëse.

Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, edhe emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim që aplikimi i njëjtë nuk është dorëzuar në asnjë organ tjetër të miratuar;

c) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e paraparë të lëndës plasëse;

ç) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

d) dokumentacionin teknik për tipin e miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese tip CE.

3.2 Sistemi i cilësisë siguron që lëndët plasëse janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji.

Sistemi i cilësisë siguron që lëndët plasëse janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që përmbush kërkesat e legjislacionit që aplikohen për ato.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt, në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve me shkrim. Dokumentimi në lidhje me sistemin e cilësisë mundëson një interpretim konsistent të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave për cilësinë.

Ato duhet të përmbajnë sidomos një përshkrim të saktë të:

a) objektivave të cilësisë, si dhe të strukturës organizative, përgjegjësive dhe kompetencave të drejtuesve në lidhje me cilësinë e produktit;

b) teknikat dhe proceset korresponduese të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe garancisë dhe veprimet sistematike që do të përdoren;

c) ekzaminimet dhe testet që do të kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe sa shpesh do të kryhen ato;

ç) dokumenteve të cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit dhe raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.; dhe

d) mjeteve të e monitorimit të realizimit të cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimit efikas të sistemit të cilësisë.

3.3 Organi i miratuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3.2.

Ai duhet të prezumojë përputhshmërinë me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet e standardit relevant të harmonizuar.

Përveç përvojës me sistemet e menaxhimit të cilësisë, grupi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me përvojë në vlerësim për fushën relevante të prodhimit dhe teknologjisë së saj dhe të ketë njohuri të kërkesave të zbatueshme të këtij ligji. Auditi përfshin edhe një vizitë vlerësuese në mjediset e prodhuesit. Ekipi i auditimit shqyrton dokumentacionin teknik të paraparë në pikën 3.1(e), për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të përmbushur kërkesat përkatëse të këtij ligji dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e artikullit piroteknik me këto kërkesa.

Prodhuesi njoftohet për vendimin. Njoftimi përmban përfundimet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuesi duhet të marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta mbajë atë në një nivel të përshtatshëm dhe efikas.

3.5 Prodhuesi duhet ta mbajë vazhdimisht të informuar organin e miratuar që ka miratuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim të propozuar të sistemit të cilësisë.

Organi i miratuar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i ndryshuar do të vazhdojë t'i përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 apo nëse nevojitet rivlerësim.

Vendimi i arsyetuar i vlerësimit duhet t'i bëhet i ditur prodhuesit. Njoftimi përmban rezultatet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të miratuar.

4.1 Qëllimi i monitorimit është garantimi që prodhuesi i përmbush siç duhet detyrimet që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2 Prodhuesi lejon organin e miratuar që të hyjë në mjediset e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit për qëllime inspektimi dhe t'i japë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentet në lidhje me sistemin e cilësisë;

b) raportet e cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.

4.3 Organi i miratuar kryen auditime periodike për të garantuar që prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i japë atij raportin e auditimit.

4.4 Përveç kësaj, organi i miratuar mund të bëjë vizita të panjoftuara te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i miratuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste ose të caktojë të tjerë për kryerjen e tyre, me qëllimin për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë funksionon siç duhet. Organi i miratuar duhet t'i japë prodhuesit raportin për vizitën e kryer dhe, nëse janë kryer teste, raportin e testimeve.

5. Markimi CE dhe Deklarata e përputhshmërisë CE

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe nën përgjegjësinë e organit të miratuar të cilit i referohet pika 3.1., vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit te çdo lëndë plasëse që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë më shkrim të përputhshmërisë CE për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet, që nga koha kur lënda plasëse është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon artikullin piroteknik për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

6. Prodhuesi vë në dispozicion të autoriteteve të vendit për një periudhë 10-vjeçare, pas vendosjes në treg të lëndës plasëse, si më poshtë:

a) dokumentacionin e referuar në pikën 3.1;

b) informacionin që ka të bëjë me ndryshimin të referuar në pikën 3.5, të miratuar;

c) vendimet dhe raportet e organit të miratuar të referuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo organ i miratuar informon autoritetet notifikuese për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara apo të tërhequra dhe në mënyrë periodike apo në vijim të kërkesës, vë në dispozicion të autoriteteve notifikuese listën e sistemit të cilësisë, të miratuar, refuzuar, pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organ i miratuar informon organet e tjera të notifikuara për miratimin e sistemit të cilësisë të cilat ai ka refuzuar, pezulluar, tërhequr apo kufizuar dhe në vijim të kërkesës vë në dispozicion miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandat.

MODULI E
Përputhshmëria me tipin bazuar në garantimin e cilësisë së produktit

1. Përputhshmëria me tipin e bazuar në cilësinë e procesit të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2 dhe 5, siguron dhe deklaron me përgjegjësi vetëm të tij se lëndët plasëse në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji.

2. Prodhimi

Prodhuesi përdor një sistem të miratuar cilësie për inspektimin dhe testimin e lëndëve përkatëse plasëse, siç specifikohet në pikën 3 dhe ai i nënshtrohet monitorimit të përmendur në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

3.1 Prodhuesi i paraqet organit të miratuar, të zgjedhur prej tij, një aplikim për vlerësimin e sistemit të cilësisë për lëndët plasëse në fjalë.

Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, edhe emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim që aplikimi i njëjtë nuk është dorëzuar në asnjë organ tjetër të miratuar;

c) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e paraparë të lëndës plasëse;

ç) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

d) dokumentacionin teknik për tipin e miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese tip CE.

3.2 Sistemi i cilësisë siguron që lëndët plasëse janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt, në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve me shkrim. Dokumentimi në lidhje me sistemin e cilësisë mundëson një interpretim konsistent të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave për cilësinë.

Ato duhet të përmbajnë sidomos një përshkrim të saktë të:

a) objektivave të cilësisë, si dhe të strukturës organizative, përgjegjësive dhe kompetencave të drejtuesve në lidhje me cilësinë e produktit;

b) ekzaminimet dhe testet që do të kryhen pas prodhimit;

c) dokumentimit të cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit dhe raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.; dhe

ç) mjeteve të monitorimit të funksionimit efikas të sistemit të cilësisë.

3.3 Organi i miratuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3.2.

Ai duhet të prezumojë përputhshmërinë me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet e standardit relevant të harmonizuar.

Përveç përvojës me sistemet e menaxhimit të cilësisë, grupi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me përvojë në vlerësim për fushën relevante të prodhimit dhe teknologjisë së saj dhe të ketë njohuri të kërkesave të zbatueshme të këtij ligji. Auditi përfshin edhe një vizitë vlerësuese në mjediset e prodhuesit. Ekipi i auditimit shqyrton dokumentacionin teknik të paraparë në pikën 3.1(e) për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të këtij ligji dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e lëndës plasëse me këto kërkesa.

Prodhuesi njoftohet për vendimin. Njoftimi përmban përfundimet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuesi duhet të marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta mbajë atë në një nivel të përshtatshëm dhe efikas.

3.5 Prodhuesi duhet ta mbajë vazhdimisht të informuar organin e miratuar që ka miratuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim të propozuar të sistemit të cilësisë.

Organi i miratuar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i ndryshuar do të vazhdojë t'i përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 apo nëse nevojitet rivlerësim.

Vendimi i arsyetuar i vlerësimit duhet t'i bëhet i ditur prodhuesit. Njoftimi përmban rezultatet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të miratuar

4.1 Qëllimi i monitorimit është garantimi që prodhuesi i përmbush siç duhet detyrimet që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2 Prodhuesi e lejon, për qëllime vlerësimi, organin e miratuar që të hyjë në mjediset e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit për qëllime inspektimi dhe t'i japë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

b) raportet e cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.

4.3 Organi i miratuar kryen auditime periodike për të garantuar që prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i japë atij raportin e auditimit.

4.4 Përveç kësaj, organi i miratuar mund të bëjë vizita të panjoftuara te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i miratuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste ose të caktojë të tjerë për kryerjen e tyre, me qëllimin për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë funksionon siç duhet. Organi i miratuar duhet t'i japë prodhuesit raportin për vizitën e kryer dhe, nëse janë kryer teste, raportin e testimeve.

5. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë CE

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe nën përgjegjësinë e organit të miratuar të cilit i referohet pika 3.1, vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit te çdo lëndë plasëse që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë CE për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet, që nga koha kur lënda plasëse është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon lëndën plasëse për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

6. Prodhuesi vë në dispozicion të autoriteteve të vendit për një periudhë 10-vjeçare, pas vendosjes në treg të lëndës plasëse, si më poshtë:

a) dokumentin e referuar në pikën 3.1;

b) informacionin që ka të bëjë me ndryshimin e referuar në pikën 3.5, të miratuar;

c) vendimet dhe raportet e organit të miratuar, të referuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo organ i miratuar informon autoritetet notifikuese për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara apo të tërhequra dhe në mënyrë periodike apo në vijim të kërkesës, vë në dispozicion të autoriteteve notifikuese listën e sistemit të cilësisë, të miratuar, refuzuar, pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organ i miratuar informon organet e tjera të miratuara për miratime të sistemit të cilësisë të cilat ai ka refuzuar, pezulluar, tërhequr apo kufizuar dhe në vijim të kërkesës vë në dispozicion miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6, mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandat.

MODULI F
Përputhshmëria me tipin e bazuar në verifikimin e produktit

1. Përputhshmëria me tipin e bazuar në cilësinë e procesit të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2, 5.1 dhe 6, siguron dhe deklaron me përgjegjësi vetëm të tij se lëndët plasëse në fjalë, që i janë nënshtruar dispozitave të pikës 3, janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE.

2. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë përputhshmërinë e lëndës së prodhuar plasëse me kërkesat e aplikueshme të përshkruara në certifikatën ekzaminuese tip CE.

3. Verifikimi

Një organ i miratuar, i zgjedhur nga prodhuesi, kryen ekzaminimet dhe testet përkatëse, për të kontrolluar përputhshmërinë e lëndës plasëse me tipin e miratuar e të përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe me kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

Ekzaminimet dhe testet për të kontrolluar përputhshmërinë e lëndëve plasëse me kriteret e duhura, kryhen sipas zgjedhjes së prodhuesit ose duke ekzaminuar dhe testuar çdo produkt, siç përcaktohet në pikën 4 ose duke ekzaminuar dhe testuar lëndët plasëse në baza statistikore, siç përcaktohet në pikën 5.

4. Verifikimi i përputhshmërisë me anë të ekzaminimit dhe testimit të çdo produkti

4.1 Të gjitha lëndët plasëse duhet të ekzaminohen apo testohen siç duhet në mënyrë individuale, siç parashikohet te standardet relevante të harmonizuara dhe/ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera relevante teknike, të kryhen në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me tipin e miratuar të certifikatës ekzaminuese tip EU. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, organi i miratuar vendos për testin përkatës që duhet të kryhet.

4.2 Organi i miratuar lëshon një certifikatë të përputhshmërisë në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe të vendosë numrin e identifikimit te secila lëndë plasëse e miratuar apo ta vendosë atë nën përgjegjësinë e saj.

Prodhuesi ruan certifikatat e përputhshmërisë dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve të vendit për inspektim për 10 vjet, pasi lënda plasëse të jetë vendosur në treg.

5. Verifikimi statistikor i përputhshmërisë

5.1 Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë homogjenitet për secilin grup produktesh të prodhuara dhe t'i paraqesë lëndët e tij plasëse për verifikim në grupe produktesh.

5.2 Mostrat e rastësishme duhet të merren nga secili grup produkti. Të gjitha lëndët plasëse të një mostre të ekzaminohen dhe testohen në mënyrën e duhur, siç përcaktohet te standardet relevante të harmonizuara dhe testet ekuivalente, siç përcaktohen në specifikimet e tjera teknike, të kryhen në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me tipin e miratuar të përshkruar te certifikata ekzaminuese e tipit CE dhe për të përcaktuar nëse grupi i produkteve është pranuar apo refuzuar. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, organi i miratuar në fjalë të vendosë për testet e përshtatshme që do të kryhen.

5.3 Nëse një grup produktesh pranohet, të gjitha lëndët plasëse të grupit të produkteve konsiderohen të pranuara, përveç atyre lëndëve plasëse që në bazë të mostrës, nuk përmbushin kriteret e testimit.

Organi i miratuar lëshon një certifikatë të përputhshmërisë në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe vendos numrin e tij të identifikimit te secila lëndë plasëse e miratuar ose e vendos atë nën përgjegjësinë e saj.

Prodhuesi ruan certifikatat e përputhshmërisë dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve të vendit për inspektim për 10 vjet, pasi lënda plasëse të jetë vendosur në treg.

5.4 Nëse një grup produktesh refuzohet, organi i miratuar apo autoriteti kompetent merr masat e duhura për parandalimin e vendosjes në treg të këtij grupi produktesh. Në rast të refuzimit të shpeshtë të grupeve të produkteve, organi i miratuar mund të pezullojë verifikimin statistik dhe të marrë masat e duhura.

6. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë CE

6.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe nën përgjegjësinë e organit të miratuar të cilit i referohet pika 3, vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit te çdo lëndë plasëse që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

6.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë CE për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet, që nga koha kur lënda plasëse është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon lëndën plasëse për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

Nëse organi i miratuar i referuar në pikën 3 është dakord dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë te lëndët plasëse numrin e identifikimit të organit të miratuar.

Nëse organi i miratuar është dakord dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë te lëndët plasëse numrin e identifikimit të organit të miratuar gjatë procesit të prodhimit.

7. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandat. Një përfaqësues i autorizuar mund të mos përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5.1.

MODULI G
Përputhshmëria e bazuar te verifikimi i njësisë

1. Përputhshmëria e bazuar te verifikimi i njësisë është procedura e vlerësimit të përputhshmërisë me anë të së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 5 dhe garanton e deklaron me përgjegjësinë e tij të vetme se lënda plasëse në fjalë, objekt i dispozitave të pikës 4, është në përputhje me kërkesat e këtij ligji që aplikohen për atë.

2. Dokumentacioni teknik

2.1 Prodhuesi përpilon dokumentacionin teknik dhe e vë atë në dispozicion të organit të miratuar të referuar në pikën 4. Dokumentacioni mundëson vlerësimin e përputhshmërisë së lëndës plasëse me kërkesat përkatëse dhe duhet të përfshijë një analizë adekuate dhe vlerësimin e riskut. Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e zbatueshme dhe, sa i përket vlerësimit, ai përfshin projektimin, prodhimin dhe funksionimin e lëndës plasëse. Dokumentacioni teknik, kudo që është i zbatueshëm, duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të përgjithshëm të lëndës plasëse;

b) projektin konceptual, skicime të prodhimit dhe diagrame të komponentëve, nënkomplete, qarqe etj.;

c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar ato projektime dhe skicime, si dhe funksionimin e lëndës plasëse;

ç) listën e standardeve të harmonizuara që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, dhe në rast të moszbatimit të standardeve të harmonizuara, të japë përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për përmbushjen e kërkesave kryesore të sigurisë e këtij ligji, duke përfshirë edhe një listë tjetër përkatëse të specifikimeve teknike të aplikuara. Në rast të zbatimit të pjesshëm të standardeve të harmonizuara, dokumentacioni teknik specifikon pjesët të cilat janë zbatuar;

d) rezultatet e llogaritjeve të projektit dhe ekzaminimet e kryera etj.;

dh) raportet e testit.

2.2 Prodhuesi ruan dokumentacionin teknik dhe e vë në dispozicion të autoriteteve përkatëse të vendit për 10 vjet, pasi lënda plasëse të jetë vendosur në treg.

3. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë përputhshmërinë e lëndës plasëse të prodhuar me kërkesat e aplikueshme të këtij ligji.

4. Verifikimi

Një organ i miratuar, i zgjedhur nga prodhuesi, kryen ekzaminimet dhe testet përkatëse, të përcaktuara te standardet përkatëse të harmonizuara dhe/ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikime të tjera teknike, për të kontrolluar përputhshmërinë e lëndës plasëse me kërkesat e zbatueshme të këtij ligji ose t'i kryejë përmes të tjerëve. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, organi në fjalë i miratuar vendos për kryerjen e testeve të duhura.

Organi i miratuar lëshon një certifikatë përputhshmërie në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe vendos numrin e identifikimit te lënda plasëse e miratuar ose e vendos atë numër me anë të të tjerëve, nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi ruan certifikatat e përputhshmërisë dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve të vendit për inspektim për 10 vjet, pasi lënda plasëse të jetë vendosur në treg.

5. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë CE

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe nën përgjegjësinë e organit të miratuar, të cilit i referohet pika 4, vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit te lëndët plasëse, që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë më shkrim të përputhshmërisë CE për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet, që nga koha kur lënda plasëse është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon lëndën plasëse për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

6. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 2.2 dhe 5 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandat.

SHTOJCA IV
DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË

1. Nr. … (produkt, tip, numër ngarkese apo numër serie):

2. Emri dhe adresa e prodhuesit dhe kur nevojitet edhe ato të përfaqësuesit të autorizuar.

3. Kjo deklaratë e përputhshmërisë lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit.

4. Objekti i deklaratës (identifikimi i produktit që mundëson gjurmimin e lëndës plasëse).

5. Objekti i deklaratës i përshkruar më lart është në përputhje me legjislacionin relevant të harmonizuar të Bashkimit Evropian.

6. Referencat në lidhje me standardet e përdorura relevante të harmonizuara apo referencat e specifikimeve të tjera teknike në lidhje me përshtatshmërinë e deklaruar:

7. Organi i miratuar... (emri, numri) ka kryer... (përshkrimin e ndërhyrjes) dhe lëshon certifikatën:

8. Informacion shtesë:

E nënshkruar për dhe në emër të:

(vendi dhe data e lëshimit):

(emri, funksioni)

(nënshkrimi):